

VANGJUSH ZIKO

MOIKOM ZE QO
CENTAURI
I POEZISË MODERNE

Westprint

Tiranë, 2019

Autori:
Vangjush Ziko

Titulli i librit:
Moikom Zeqo
Centauri i poezisë moderne

Shtëpia Botuese:
Westprint

Pergatiti:
Rolan GJOZA
Anton PAPLEKA

Redaktor:
Fatmir MINGULI

Arti grafik:
Xhina ÇAÇI

Kopertina:
Në kopertinë

ISBN:

© Copyright, 2019: Vangjush Ziko

Kujtimit të poetit lirik Dhorë Qiriazë

Vangjush ZIKO





Vangjush Ziko

DY FJALË LEXUESIT

Në këtë libër mblodha shkrimet e mia mbi kozmologjinë poetike të poetit **Moikom Zeqo**, të shkruara gjatë këtyre dy viteve të fundit.

Të shkruash për këtë krijimtari, sigurisht, nuk është gjë e lehtë.

Poezia e Moikomit është një model i paparë më parë në poezinë tonë.

Ajo ka sjellë jo vetëm një tematikë krejt të re. Por, mbi të gjitha, një koncept krejt të ri modern mbi krijimtarinë poetike.

Është shekulli kur poezia botërore po ecën krahas me një realitet, një koncept dhe perceptim krejt të ri mbi realitetin.

Horizonte të reja i janë hapur letërsisë dhe botëkuptimit filozofik gjatë më shumë se një shekulli.

Teori të reja kanë lindur mbi botën, që na rrethon dhe realitetin. Siç janë *mekanika kuantike dhe teoria e relativitetit*.

Veprimet dhe mendimet e reja ndikojnë dhe tek ne.

Sot bëhet fjalë për trurin dhe ndërgegjen kuantike, për një psikologji të re, e cila e shikon Njeriun si kuant të sistemit universal. Si një qenie e ndërvarur me mjedisin në të cilin jeton.

Që në fillim të shekullit të kaluar filloi procesi i rishikimit dhe modernizimit të krijimtarisë letrare me James Yoce, Borgesin dhe me korifejtë e poezisë botërore Whitman, Eliot. Rilke, me futuristët dhe rrymat moderne dhe postmoderne.

Nga shkrimtarët tanë të ditëve tona është në avangardë poeti ynë Moikom Zeqo.

Krijimtaria e tij ka sjellë një risi të paparë në poezinë tonë.

Risija e tij ka të bëjë me procesin e perceptimit dhe të mishërimit konceptual të realitetit dhe me "rimagnetizimin" e figurave artistike, të metaforës dhe të alegorisë.

Ai arrin të krijojë figura të plota dhe të pandara midis subjektit dhe objektit, midis tokësore dhe universale, duke arritur një pasqyrim kompleks të përmbajtjes të procesit të mendimit dhe po aq të stërholluar të perceptimit artistik.

Poezia e Moikomit kërkon, jo vetëm një lexues të ri, të vemendshëm por edhe të mirëpërgatitur kulturalisht.


Këtë lexues do ta përgatitë vetë krijimtarie dhe filozofia e tij krijuese.

Unë u përpoqa me modesti dhe pëkushtim ta komentoj dhe interpretoj kozmogoninë poetike të Moikom Zeqos.

Do të jem i kënaqur në qoftë se do të kem arritur diçka të vyer për Ju.

Vangjush ZIKO

5 nëntor 2019, Kanada



PËRMBAJTJA

**STUDIME PËR POETIKËN
E MOIKOM ZEQOS**



Vangjush Ziko

CENTAURI I POEZISË MODERNE

Moikom Zeqo është një ndër intelektualët më të veçantë në historinë e letërsisë sonë kombëtare, një personalitet poliedrik. Interesat e tij intelektuale janë të shumëllojta. Ato u përkasin fushave të ndryshme të veprimtarisë njerëzore: historisë, arkeologjisë, letërsisë, muzikës, pikturës, antikitetit dhe aktualitetit.

Veprimtaria e tij shtrihet në dy fusha krejt të ndryshme përse i përket specifikës së formës e të objektit të tyre: artit dhe shkencës. Kjo e vështirëson përcaktimin e atributit thelbësor të veprimtarisë së tij, për specifikën dhe mënyrën se si i qaset dhe se si e realizon këtë.

Veprimtaria krijuese artistike e riprodhon realitetin nëpërmjet figurave artistike.

Veprimtaria shkencore e bën këtë nëpërmjet njohurive konkrete dhe të ligjeve të zhvillimit të natyrës dhe të shoqërisë njerëzore.

Veprimtaria krijuese artistike ka në bazë

Besimin, ndërsa veprimtaria shkencore ka Njohjen.

Kur them Besimin, nuk kam aspak parasysh besimin religjioz, por besimin e njeriut për të zbuluar diçka të re. Ky besim nxitet nga bindja e fortë se kjo diçka është e vërtetë ose do të realizohet patjetër. Gjë e cila do të thotë se bëhet fjalë për diçka, që nuk njihet ende. Pra, në bazë të besimit qëndron Paditura. E thënë ndryshe, fjala “besoj” do të thotë “unë nuk e di”. Ndyshe nga veprimtaria krijuese artistike, veprimtaria shkencore është dituri, njohje.

Vetvetiu lind pyetja se si arrin Moikomi t'i sinkronizojë në veprimtarinë e vet shpirtëroren me materialen, artin me shkencën.

Pa diskutim që motivi kryesor, që i lidh këto të dyja, ka të bëjë me natyrën dhe karakterin e poetit, të cilin e karakterizon pasioni i zbulimit të diçkaje të re. Në bazë të kësaj është “instikti”.

E vura në thonjëza këtë fjalë, sepse shkenca “instiktin” e ka zëvendësuar me fjalën “ndërgjegje” kur bëhet fjalë për njeriun. Instikti i përket botës së kafshëve.

Sipas psikologut Mak Dugall, “instiktet” njerëzore, janë motive shumë të fuqishme në sjelljen e një tipi të caktuar. Në listën e klasifikimit të këtyre “instikteve” ai, midis të tjerave, vendos këto dy: dëshirën për dituri (habinë) dhe vetë afirmimin

(frymëzimin). Sipas këtij klasifikimi, dëshira për dituri i përket Shkencës, kurse vetë afirmimi, Artit.

Moikomin do ta quaja figurativisht një “kentaaur” sui generis.

Dy janë fytyrat intelektuale të tij, ajo e Poetit dhe ajo Shkencëtarit, pasioni për art dhe pasioni për dituri. Të shumta janë kërkimet dhe studimet e tij në fushën e arkeologjisë, hulumtimet e tij mbi artin botëror, mbi antikitetin, mbi figura të shquara të kulturës kombëtare dhe asaj botërore, interpretime dhe komente mbi Biblën, mbi legjendat dhe paradokset metafizike, mbi artin dhe pikturën, muzikën, ikonografinë, mbi enigma të besimeve të ndryshme, mbi magjinë dhe kabalistikën etj., etje. Të gjitha këto përbëjnë pasurinë e tij intelektuale dhe atë shpirtërore.

Asnjëherë Moikomi nuk e ka quajtur veten e vet shkencëtar. Studjues, eseist po. Ai e quan veten Poet. Pa diskutim. Frymëzimi i tij poetik, patjetër, nis fluturimin e vet bashkë me “bagazhin” e vet diturak. Ky është thesari i tij intelektual i pashoq.

E vërtetë është, gjithashtu, se Moikomi ka patur një tërheqje të përkohshme nga krijimtaria poetike, në ato vite kur u kritikua për hermetizmin e krijimtarisë së tij dhe iu drejtua tërësisht arkeologjisë. Në librin e tij “Këmbësori kozmik”, ai na e pohon këtë:

*“Tri herë e kam mohuar Poezinë
Si Shën Pjetri mohoi Krishtin”*

Në librin “Kentauri i fundit” ai na e ripohon këtë dilemë të vetën, kur shkruan se ai “është dëshpëruar nga poezia”, por pohon edhe të vërtetën tjetër: “Jashtë krizës nuk ka poezi. Pakënaqësia lind vizionet e mëdha”.

Po në këtë libër ai na pohon të vërtetën tjetër të përkushtimit të tij sublim ndaj artit poetik: “Të çburgosësh poezinë, është mrekullia e intelektit njerëzor”. Ai beson në “rikthimin e përjetshëm, tek fuqia e fthillëzimeve në botën kuantike të metaforave” dhe në “sekretet gnostike të fjalëve”. Ai vërtet duket “i çuditshëm dhe i marrë”!

Ky është poeti Moikom Zeqo, Centauri i poezisë sonë moderne.

SEKRETI I FLUTURIMEVE PINDARIKE

E lexova me kureshtje dhe kënaqësi librin poetik të Moikom Zeqos “Letrat për Makabe Zaharian”, botim i APARKEAS-ABRAXAS, 2017.

Poezia e Moikomit është poezi e veçantë, e cila kërkon një përqëndrim maksimal. Ajo të emocionon dhe të zgjon mendime asociative komplekse dhe të thella, është një poezi e përjetimeve jo të zakonshme, të bukura dhe alternative. Është, pra një poezi thellësisht bashkëkohore, që i flet mendjes dhe zemrës, kujtesës, përfytyrimit dhe ëndërrimeve.

Nuk po përqëndrohem në një analizë të thelluar të brendisë së saj. E quaj ordiner, të thjeshtëzuar, kalimtar një koment dhe riinterpretim me fjalë të bukura boshe të të vërtetave filozofike dhe estetike të mishëruara në prozodinë dhe në figuracionin e saj. Poezia e vërtetë ka nevojë për një

gjykim të argumentuar teorik dhe të interpretuar profesionalisht.

Duke lexuar dhe rilexuar krijimtarinë poetike të Moikom Zeqos, nuk po e quaj thjesht Poet, sepse më duket e ngushtë kjo “këmishë”, “kostumi” i tij më ngjan edhe me togën antike, edhe me pelerinën kalorësiake, po edhe me smokingun e një “dandy”, bile edhe me fustanellën tonë të pashembullt ilire.

Më vjen mirë ta quaj edhe Filozof, e quaj edhe Magjistar, pse të mos e quaj edhe Njeri jo të zakonshëm, i cili i mban sytë nga qielli duke lexuar **Zodiakun** e fatit njerëzor mbi tokë.

Kam përshtypjen se kur lindi frymëzimi i tij, Muza e ka pritur në pelenën e Alegorisë, pelenën, e cila i shkaktoi plot shqetësime, kur në ato vite shkruhej, kryesisht, poezi politike. Ajo poezi ishte poezia e argumentimit politik.

Si mund ta duronte Moikomi i ri këtë sfidë?

Heroi lirik i tij, megjithatë, nuk hoqi dorë asnjëherë si atëherë si dhe tani nga kjo figurë sfiduese e realitetit dogmatik. Ai e përdori edhe atë me kujdes duke vënë shprehjen e figurshme në themel të stilistikës së tij poetike. Mbi këtë themel ai e lartësoi hap pas hapi korpusin e veprës së vet, duke e bërë devizë të kredos poetike

Alegorinë, e cila e përsos dhe e bën mjeshtërore shprehjen e figurshme të mendimeve. Alegoria si figurë artistike na jep kontekstin e mendimit në përgjithësi, e vesh me velon e vet atë e, si çdo gjë e mbuluar, zgjon në forma të befta kërshërinë. Të bën të mendosh dhe të përfytyrosh.

Por frymëzimit universal të Moikomit nuk i mjaftonte vetëm thjesht përfytyrimi i sendeve dhe i ngjarjeve të zakonshme, përfytyrimi i përditshmërive të zakonshme dhe profane tokësore. Heroi i tij lirik është vizionar. Atë e interesojnë jeta dhe vdekja, pavdekësia dhe pafundësia, e tashmja dhe e ardhmja dhe përtejardhmëria. Realja plekset te ai me metafiziken, truporja me shpirtëroren, ëndrra me zhgjëndrën, Parajsa me Ferrin, konkretja me abstrakten.

Vizioni i tij filozofik dhe estetik nuk kishte si të realizohej vetëm me “magjinë” e Alegorisë së zakonshme jetësore. Nuhatja e tij artistike dhe estetike e drejtuan atë në korpusin e mitologjisë antike, në mitet. Vizionit të frymëzimit të tij i duhej “Alegoria mitologjike” mbi kozmosin, mbi zotat, mbi njerëzit, sinkretizimi i njeriut me natyrën, i së kaluarës me të tashmen, i trillimit me realen. Ai i studioi dhe i bëri të vetat këto sekrete të mjeshtërisë mitologjike. Kuptoi dhe përvetësoi si askush këto

koncepte dhe “asociacione të pathëna paraprahe”.

Poezia e tij u bë kështu prej vitesh universalisht një poezi konceptuale figurative, duke vënë në themel të stilistikës së vet metodën avangardiste, që solli shekulli i njëzetë në krijimtarinë letrare, konceptualitetin.

Në stilistikën e Moikom Zeqos janë të pranishme edhe elemente të postmodernizmit, siç është mistifikimi i realitetit, operimi me figura dhe tekste të së kaluarës, por edhe një rikthimi i habitshëm në fluturimet e befasishme të Pindarit antik, kaq të parapëlqyera prej tij.

Metaforat dhe personifikimet e Moikomit janë, sipas përcaktimit të tij, “mashtime optike për të krijuar asimetri të frikshme”.

Një mendim të përafërt me poetin tonë e shpreh edhe poeti Joseph Mosconi: *“Më pëlqen që të mendoj për poezinë konceptuale, si për fëmijët me sy të zes, që duam t’i vëmë në gjumë, jo që t’i mbrojmë dhe t’i mitologjizojmë, por të ecim më tej, që të shpërndajmë fantazmat në familje”*.

Qëllimi i Moikomit nuk është, thjesht, risjellja e mitologjisë apo rikopjimi i miteve dhe i figurave të saj mitologjike, as t’i depozitojë e koleksionojë ato në vargjet e veta. Moikomi nuk do të na mahnitë apo të na “trembë” me hijen e tyre të rëndë, të


mbinatyrshe. Poeti ynë i çmitizon ato dhe, nga “fantazma”, na i bën simbole. Ose i bën edhe metafora të koncepteve, të ideve dhe të kategorive universale të moralit, të bukurisë, të dashurisë, të madhësisë, të heroizmit dhe të poshtërsisë, të dlijësisë, të kohës dhe të pavdekësisë. Si përfundim, kjo stilistikë poetike kërkon dhe një psikofizikë të re leximi, pra edhe një raport të ri Poet-Lexues.

Poezia e Moikom Zeqos përfshin në vetvete të sotmen, bashkë me të shkuarën dhe të ardhmen, sintezën e kohërave shpirtërore.

Gjuha e poezisë së vërtetë, niveli kulturor, pa harruar dhe nivelin gjuhësor, nuk është kurrë e barabartë me nivelin kulturor si dhe gjuhësor të lexuesit, ajo (e para) i paraprin asaj (së dytës), rëndësi ka që lexuesi të kapë si duhet dhe me inteligjencë thelbin e poezisë.

Stilistika poetike e Moikom Zeqos është kurorëzimi i plotë i rrugës së tij krijuese në të gjitha aspektet letrare e jashtëletrare.

Për letërsinë shqipe kjo është një arritje madhore, që e radhit atë me dinjitet, krahas poezisë bashkëkohore moderne botërore.



STILI I JASHTËZAKONSHËM

Moikom Zeqo është një krijues shumëplanësh, historian, arkeolog, piktor, studiues, eseist, kritik, aktivist shoqëror dhe politik, një intelektual shumëdimensional, di disa gjuhë të huaja dhe ka një horizont të rrallë kulturor. Fjala e tij poetike është e rrallë për nga dimensionet e saj semantike dhe për nga përmasat konotative, kuptueshmëritë e saj të shumta figurative. Ajo prek caqet e enigmës dhe nuk është lehtë për të depërtuar në thellësitë e saj artistike dhe estetike. Të veçanta janë metaforat dhe alegoritë si dhe teknikat e tij kompozicionale, pra, një poet me një stil të jashtëzakonshëm.

FJALA POETIKE

Fjala në vetvete, si shenjë, ka shtrirje të ndryshme semantike reale dhe potenciale. Kuptimi real ngërthen në vetvete kuptimin minimal të saj. Kuptimi potencial nënkupton një nocion më të gjerë difuziv semantik, nënkupton shfrytëzimin

maksimal semantik të fjalës. Detyra e poetit është që të zbulojë thellësinë semantike të fjalës duke e shfrytëzuar tërë hapësirën e mundshme potenciale konotative të saj, e cila mund ta shndërrojë atë deri në kufijtë e një enigme. Kjo është enigma e fjalës poetike të Zeqos.

Edhe vetë poeti i bën pytjen vetes:

*"Pse fjala ime
Është kaq e ndjeshme
si në studimin laboratorik?"*

Gjuha poetike e Moikomiti është gjuhë impulsive me një ngarkesë maksimale. Ai është poet emocional, vazhdimisht i shqetësuar, laborator i tij gjuhësor është gjithmonë në kërkim të fjalës me ngarkesë semantike jo të zakonshme, që përpiqet të përcjellë të plotë mendimin dhe ndjenjën e vet. Ai, sikurse shkruan poeti, është "skllavi i fjalës, për t'u dhënë liri mendimeve".

Duke perifrastuar një mendim të Laibnicit, Moikomi guxon t'i shkojë deri në fund thellimit semantik të fjalës, gjë e cila e çon atë në thelbin e saj. "Fjalët e mia, thotë ai, janë si epruveta të thyera të një laboratorit alkimist". Dhe ai, si një

alkimist i vërtetë, shkruan fjalë “për të qenë një mobilim inteligjent i zbrazëtirës dhe heshtjes!”. Ai i ripërtërin dhe i shumëfishon kuptimet semantike të fjalës duke i bërë ato “ikona lëvizëse” të mendimit. Fjalët e tij janë “gra, për të lindur njëmijë Krishtër” dhe “material ndërtimi” për të ndërtuar qytete. Ky është qëndrimi i tij semantik ndaj fjalës poetike.

E tërë godina e tij e çuditshme poetike është ngritur me këtë “material”. Ai e ka kuptuar të vërtetën e madhe, që e ka formuluar qartë Josif Brodski:

“Gjuha nuk është instrument i poetit, por ai vetë është mjet i gjuhës. Poeti është mjete i ekzistencës së gjuhës” dhe i pafundësisë kuptimore të saj.



MJESHTËRIA METAFORIKE

Aseti i fjalës poetike e ka bërë poetin mjeshtër të rrallë të metaforës dhe të alegorisë. Me ato ai arrin të komunikojë emocionalisht dhe maksimalisht ndjenjat dhe mendimet e veta. *“Imazhet dhe metaforat e Zeqos, shkruan Wayne Miller, grumbullohen dhe ngatërrohen për të formuar labirinte marramendëse gjuhësore”*.

Metafora është një nga mjetet kryesore të njohjes së objekteve të realitetit, të emrave të tyre, të krijimit të imazheve artistike dhe të gjenerimit të kuptimeve të reja. Metafora në letërsi synon konkretizimin e vet maksimal. Metafora kryen funksione nga më të ndryshmet: kognitive, gnoseologjike, nominative, artistike dhe semantike.

Moikomiti intereson metafora artistike me natyrë racionale, e cila krijon figura “super të ndjeshme”, që pasurojnë në pafundësi kuptueshmërinë e mendimit artistik duke transmetuar mendime universale kozmike, raportin eterik të kohës me dimensionet e saj të së tashmes, të së shkuarës

gërshetuar me të ardhmen.

“Instikti i metaforës tek unë, shkruan Moikomi, është në luftë me intuitën e shkencëtarit”. Ai i bën metaforat “pasqyra të absolutes”. Autori nuk analizon apo përqsas fakte, nuk nxjerr përfundime dhe formula, nuk bën deduksione, por na zgjon ndjenja të madhërishme ose të ulta duke na pasuruar imagjinatën tonë të zakonshme të Gishtos i cili “jeton bëmat e një Gjiganti”.

Heroi liriko-filozofik i Moikomitet e quan veten pjesë të harmonisë dhe të disarmonisë kozmike, ai e ndien fillesën e asaj që është e Bukura dhe e Shëmtuara. Poeti, në sintoni me mendimin aristotelian, na pohon se në hapësirën kozmike ekziston një shpirt suprem i pavarur, që e vë në lëvizje mendimin.


Ky vizion filozofik është burimi dhe çelësi kryesor për t'i kuptuar dhe interpretuar metaforat e poetit që janë pa fund dhe pafundësisht të larmishme.

Ai ka krijuar me to një Kozmogoni të paparë Alegorike, një mozaik ekstatist universal në të cilin ndjenjat dhe mendimet kanë impulse dalldije dhe një sublimim të gjuhës poetike dhe të realitetit.

Figuracioni metaforik i poezisë së Moikomitet të kujton një ëndërr plot makth ku realja me irealen

qëndrojnë bashkë, bashkëveprojnë në mënyrë të çuditshme duke të krijuar një ndjenjë ekstatike, ndjenjën e ekstazës hipnotizuese, që ngërthen në vetvete kontradiktën, praninë e nocioneve të kundërta, të pikëllimit dhe të gëzimit: “qefini i të vdekurve” bëhet “mbulesë e gostive”, përbri “sendeve efemeride” qëndron “qenia e pakufishme” njerëzore. Një tablo vërtet surrealiste, e cila të përfton ndjenja kontradiktore, trishtim dhe gëzim, çastin dhe përjetësinë.

Metaforat e Moikomit të tronditin me mesazhet e tyre të sofistikuara, duke të lënë në ndërgjegjen tënde shijen e një diçkaje sublime dhe magjepsëse, që vazhdon të të emocionojë edhe pasi e ke mbyllur librin.



TEKNIKA KOMPOZICIONALE

Poezia e Moikomit është komplekse dhe solide në llojin e vet, ka strukturën e saj kompakte, ka staturën e vet. Ajo, për mua, është një mozaik barok i kompozuar sipas një ligjësie kompozicionale strikte. Për ta kuptuar dhe shijuar plotësisht atë, pse jo, për ta bërë sa më të afërt për lexuesin e vëmendshëm, ajo do dekodifikuar. Dhe kjo nuk është aspak e lehtë, ose më mirë të themi, është e vështirë.

Për ta konkretizuar mendimin, po marr poezinë, ku përshkruhet një panoramë vjeshte, një poezi lirike në thelbin e saj, por jo vetëm kaq.

DIONISI I KRYQËZUAR NË VEND TË KRISHTIT

*Ja, shkëmbejtë,- këpucët e zotave!—Por unë, —
s’jam lustraxhiu i tyre! — Amen!*

*Agimi, — kalë, — i papikturuar, — plotësisht, — nga
artisti impresionist!*

Vjeshta, — rri, — në supet e fëmijërisë sime — si

këmishë princi, – e arnuar!

*Ah, – gjer, – në palcë, – të eshtrave, – e ndiej, –
pagjumësinë jeshile, – të pemëve!*

*Në Apokalipsin ekologjik – e gjej Dionisin, – të
kryqëzuar – në vend – të Krishtit!*

Zakonisht, në poezi të tilla mbi natyrën jepet një tablo poetike me një figurë kyçe, që përbën bërthamën e poezisë.

Në këtë poezi dhe në poezitë e Moikomiti, në përgjithësi, gjejmë jo vetëm peizazhin, por edhe përjetimet e thella të heroit lirik, i cili e përjeton në mënyrë filozofike këtë peizazh. Jo vetëm kaq. Në të nuk gjejmë një “bërthamë”, por disa “bërthama” të tilla në korelacion figurativ dhe emocional me njëra-tjetrën.

Poezia përcjell emocione reflektive të heroit lirik ndaj një “apokalipsi ekologjik”: shkëmbinjtë janë të zhveshur, agimi i kësaj dite vjeshte është i mangët (një pikturë impresioniste), Vjeshta e veshur me një “këmishë të arnuar”, që e bën ta ndiej “gjer në palcë” këtë “Apokalips”.

Poezia ka figura ndihmëse që e plotësojnë si referime të veçanta, duke përqëndruar vëmendjen e lexuesit në shenjat semantike të figurës qendrore. Këto figura (metafora, personifikimi, shprehja

hiperbolike dhe mesazhi biblik) janë shënjat e pavarura të tekstit poetik.

Për të analizuar semantikën e brendshme të figurave dhe vendin që zënë ato në strukturën e poezisë në tërësi, na duhet të veçojmë figurat kyçe si njësi individuale sintetike, jo thjesht si sende, por si ide të mendimit dhe si vlera estetike, që së bashku na përcjellin mendimin apokaliptik “të fshehur”: “shkëmbinjtë-këpucët e zotave” (të pabojatisura), agimi i papikturuar plotësisht (pikturë impresioniste); vjeshta, “këmisha e arnuar” e saj; “pagjumësia” e pemëve; Dionisi i kryqëzuar (kurbani natyrë si ndëshkim biblik); të gjitha detaje-argumenta të apokalipsit ekologjik, detaje piktoreske, detaje psiko-fizike, shqetësim, ankth, trishtimi i heroit lirik.

Kështu, duke hulumtuar natyrën substanciale të subjektit lirik, zbulojmë dhe perspektivën e gjykimit të kësaj tabloje nga ana e poetit: ndëshkimin universal biblik.

Ndërgjegjja krijuese e autorit na flet kështu, jo thjesht për një mbresë, për një përjetim impresionist të çastit, por për një subkoshiencë universale njerëzore, që ka të bëjë me një katastrofë universale, e cila është e denjë për një hero emblematik, që sakrifkohet për një të mirë universale. Jo më kot

poeti e përqsas figurën e perëndisë antike të bollëkut dhe të gëzimeve tokësore, Dionisin, me Krishtin e sakrifikuar nga Ati i vet për t'u treguar njerëzve se deri ku ka arritur degjenerimi i tyre.

Në këtë njëjësimit të paradigmës dhe të sintaksës së ligjërit subjekti lirik zbulon edhe perspektivën e arsyetuar të tablosë së botës prej vetë krijuesit të saj.

Poezia e Moikomiti është, mbi të gjitha, një poezi konceptuale që mbështetet në një sistem këndvështrimi shumëplanësh për të arritur qëllimin dhe kuptimin e fenomenit. Materiali tekstual renditet në një mënyrë të tillë që t'i paraqitë sa më qartë idetë. Kurse titulli i poezisë e orienton lexuesin që ta lexojë qartë këtë ide.

Moikomi i jep një rëndësi të veçantë teknikës së poezisë. Ai nuk radhit, thjesht, vargje dhe figura, ai shpalos ide dhe parashtron mendime. Siç thotë Ilia Kaminski, poeti "gërsheton referenca të ndryshme, për të krijuar një miksazh të ri të egër", një mozaik tokësor dhe kozmik, do të thosha unë.

Në çdo poezi të Moikomiti kemi një alternim disa shtresor mendimesh, figurash, emocionesh. Ato do t'i quaja "strofa" të një poeme pa fund. Ato janë strofa të mbyllura, krijime të pavarura, me një strukturë krejt të veçantë strikte.

Struktura, kompozicioni i një vepre poetike është përcaktues jo vetëm i formës, por edhe i simetrisë së mendimeve dhe të konceptit estetik dhe të atij artistik të autorit, është forma që merr plazma poetike.

Çdo poezi e Moikomit ka simetrinë dhe asimetrinë e vet. Çdo varg i saj është një nuklë poetike më vete, ashtu siç janë pjesët përbërëse të një mozaiku. Çdo cikël i tij është një mozaik më vete. Dhe ashtu siç kuptohet dhe shijohet një mozaik në bashkësinë e të gjitha detajeve dhe ngjyrave, që e përbëjnë atë, ashtu duhet lexuar, në korelacion, që të kuptohet dhe të shijohet. Çdo varg i shkëputur, i analizuar ose komentuar më vete, do ta humbte bukurinë dhe kuptimin alegorik të mozaikut. Kjo teknikë kompozicionale përbën sekretin dhe veçantinë e stilit të jashtëzakonshëm të Moikom Zeqos.

Ky kombinim ishte vërtet i paparë në poezinë tonë.

Moikomi, jo vetëm me fjalën dhe me gjuhën poetike të figurshme, por edhe me teknikën e tij të veçantë ka krijuar, tashmë, një model krejt të ri dhe të panjohur më parë nga poezia jonë.

Kjo krijimtari është komentuar dhe vlerësuar lart edhe nga studiues të huaj.

“Moikomi,- shkruan- poeti amerikan Wayne Miller, është poet i rendit të lartë poetik, autor, që përpiqet të thotë gjithçka që ai di”.

Kurse profesore Kathryn Nuernberger shkruan:

“Mund të imagjinojmë një lypës si një luan të plotë që mund të hapë gojën për të na shpjeguar lidhjet midis të gjitha gjërave të kohërave”.

META-POETIKA OSE KODI POETIK

Meta-poetika është ajo që përcakton kodin krijues të poetit.

Klara E. Shtejn, lingviste, doktore e shkencave filologjike, specialiste në fushën e metapoetikës shkruan: "*Meta-poetika është poetika sipas tekstit meta-poetik dhe metatekstit, poetika e vetë interpretimit nga autori ose prej dikujt tjetër i tekstit të tij*". Meta-poetika, sipas saj, është në koraleacion të ngushtë me disiplina të tjera shkencore, filozofike dhe artistike, siç janë: sistemi figurativ, sistemi gjuhësor, sistemi filozofik kohor, sistemi kulturor.

Poezia e Moikom Zeqos është një krijimtari e veçantë dhe komplekse që kërkon, patjetër, jo thjesht një koment letrar, por një studim dhe interpretim kompleks të shumëanshëm.

Zgjodha poezinë e tij "Psalm 153" për të bërë këtë provë modeste.

PSALMI 153

*“ O, Fjalë e vërtitshme mes hapësirave,
 që je Trandafil i Erërave!
 Pse mermeri i skalit heronjtë e vrarë mes baltës?
 Ah, përfytyrimet janë kafshët,
 që poeti i pjell në kopështin zoologjik të metaforave!
 Gjaku ikën si zvarranik i lashtë,
 i kuq në shkretëtirën blu!
 Dhe dëbora na mbështjell
 si qëndisje baroke dantellash
 bërë nga gishtat e magjishëm të ajrit!
 O, gramatika memece e pasqyrave!
 Pse fytyrën e **Arkilokut** e kam maskë
 dhe kam gjithashtu mbi supe
 një pelerinë anemonash dhe kristalesh?
 O, drita të pagjumësisë hyjnore!
 Këta semaforë janë piktura dadaiste,
 ose janë epikriza e sëmundjeve të mia
 për mjekët e kozmosit!
 Dhe qivuri prej Hëne e ka mbyllur brenda qytetin.
 Me lopata gjethesh
 e hedh dheun e dritës mbi varrin e imazhit tim!
 Mes sendeve të pavdekshme
 pse isha (jam) kaq i vdekshëm?*

Poeti, për shkruarjen e kësaj poezie, ka marrë për model Psalmin, një nga format e liturgjisë fetare.

Psalmi biblik është një thirrje drejtuar Perëdisë në formën e lutjes për mëshirë dhe zemërgjerësi. Psalmi, zakonisht, përshkruan gjendje të rënda të lutësit (sëmundje, përndjekje nga armiqtë, frikë nga vdekja).

Autori ka vendosur ta përdorë këtë veshje artistike jashtë kontekstit fetar, për të përshkruar një gjendje të vetën shpirtërore si përgjithësim filozofik dhe estetik.

Ai mbështet botëkuptimin ateist. Por shtysën, sidoqoftë, e merr nga konteksti dhe nënteksti që i jep Bibla Fjalës (e para ishte FJALA).

Edhe kjo poezi fillon me vargun: *“O, Fjalë e vërtitshme mes hapësirave”*.

Fjala këtu nënkupton, për mua, Muzën, frymëzimin e tërëpushtetshëm.

Kësaj “perëndie” i drejtohet poeti, i lutet dhe i kërkon “ndihmë” dhe “zemërgjerësi”.

Tema, qëndrore e kësaj poezie është Vdekja, kjo padrejtësi absurde e pashmangshme, një temë e pazgjithshme filozofike e ekzistencës së qenies njerëzore: *“pse isha (jam) kaq i vdekshëm?”*.

Çdo krijim poetik ka dy lexime: leximin horizontal dhe atë vertikal.

Leximi horizontal është leximi tërësor, i pandërprerë, që na përfiton brendinë e vetë krijimit poetik.

Leximi vertikal na shfaq harmonizimin e fjalëve në varg, leximin e tyre të logjikshëm, i cili na zbulon thelbin dhe llogjikën e këtij konstrukti poetik, na përcakton fjalët piketa, fjalët kyçe që e zbulojnë formën e brendshme dhe brendinë emocionale të poezisë, fjalët kyçe, që përbëjnë edhe kodin poetik të saj.

Ky kod është veçanërisht i rëndësishëm për ta kuptuar dhe vlerësuar poezinë e jashtëzakonshme konceptuale të Moikom Zeqos.

Në leximin tim, këto janë fjalët kyçe (duke ndjekur radhën në zbritje të vargjeve):

“Fjalë e vërtitshme”

“zoaranik në shkretëtirë”

“maska e Arkilokut”

“pagjumësia hyjnore”

“epikriza e sëmundjeve të mia”

“dheu i dritës”

“pse isha (jam) kaq i vdekshëm?”

Fjala e parë, në kuptimin metaforik, na flet për “flugerin”, diagramën vektoriale të mendimeve të

poetit, që vërtiten në shtjellën midis ekzistencës dhe mosekzistenës njerëzore.

Fjala e dytë aludon për përjetime të ankthshme të egra në jetën “shkretëtirë”.

Fjala e tretë na shfaq zemërimin shpirtëror të heroit lirik ndaj kësaj “shkretëtire” në mënyrë alegorike me maskën e poetit antik grek Arkilok.

Fjala e katër dhe e pestë alarmin e tij si një alarm kozmik.

Fjala e gjashtë dëshmon se lutja, psalmi i tij, është pranuar nga qielli, nga mëshira hyjnore.

Poezia mbyllet me një pyetje retorike pa përgjigje: Vdekja fizike është e pashmangshme!

Ky lexim vertikal na zbulon llojin poetik që ka zgjedhur, psalmin biblik me të gjitha shkallëzimet emocionale.

Në ndihmë të metapoetikës apo të kodit poetik vijnë edhe sistemi gjuhësor dhe ai figurativ.

Poeti u jep fjalëve ngjyrimë të shumëllojshme emocionale-artistike (“heronjtë e vrarë mes baltës”, “dheun e dritës”, “gramatika memece”); fjalë me ngjyrim filozofik (“pagjumësi hyjnore”).

Poeti nëpërmjet sistemit figurativ, pasthirmave: “O, Fjalë e vërtitshme mes hapësirave”, “O, gramatika memece e pasqyrave!”, “O, drita të pagjumësisë hyjnore!”, “Pse mermeri i skalit heronjtë e vrarë mes

baltës?”, na jep raportin e heroit lirik me fatin dhe rebelimin e tij nëpërmjet gjendjeve të ekzaltuara shpirtërore; me metaforën (“*Trandafil i Erërave*”) na flet për stuhinë e mendimeve dhe të ndjenjave, që ka pushtuar shpirtin e poetit.

Ndërsa, për ngushëllimin dhe pajtimin fatalist të heroit lirik na flet përshkrimi përngjasues i nënkuptuar mbi një funeral social dhe individual mbi një tragjedi personale dhe kolektive sociale të pashmangshme, të përligjur providencialisht:

“Dhe qivuri prej Hëne e ka mbyllur brenda qytetin.

.....

Me lopata gjethesh

e hedh dheun e dritës mbi varrin e imazhit tim!”

Ligjërimi poetik i Moikom Zeqos na dëshmon për një karakteristikë të veçantë të kodit të tij poetik, që është enciklopedizmi i tij i jashtëzakonshëm në fusha të ndryshme të dijes.

Na flet për një formim të tij të gjithanshëm, që i jep aftësinë dhe mundësinë për të krijuar një përfytyrim të intelektit dhe të botës së tij të pasur shpirtërore.

Në këtë poezi kjo shënjoheq që në titullin e saj “*Bsalm*”, i marrë nga Bibla, jo vetëm si fjalë, por

edhe si një atribut artistik i një gjinie poetike biblike, të cilën e përdor si një veshje adekuate të mendimit të tij artistik.

Piktura dadaiste i vjen në ndihmë me tiparet e saj karakteristike anarkiste për të dhënë “epikrizën” e turbullirës së vet shpirtërore përballë fatalitetit tragjik të ekzistencës. Kurse njohja e poezisë antike (maska e Arkilokut) i vjen në ndihmë për ta dhënë në mënyrë të figurshme zemërimin e tij të makthshëm dhe cinik, që i shkakton dueli absurd fatalist i qenies së tij të dënuar me asgjësim fizik.


Arkiloku është një poet antik grek, që ka shkruar vargje jambike të kumbueshme me shijen e një zemërimi përvëlues.

I tillë është vetë zemërimi i Poetit ndaj hipokrizisë fataliste që skalit në *mermer në mes të baltës bustin e "heronjtë e vrarë"*.

Dhe ashtu si e kërkon logjika hyjnore e psalmit biblik, Fjala (Muza) dhe bashkë me të “Kozmosi i pavdekshëm” i hedh mbi varr heroit lirik “*me lopata gjethesh dheun e dritës!*”

Lutja e Psalmit u pranua!

Heroit lirik të vdekshëm i premtohet Pavdekësia!



AUOPORTRETI I POETIT

Kam në dorë ciklin me poezi “Spinoza dhe Zoti” të Moikom Zeqos të shkruar në vitin 2004.

E çuditshme për një poet vizionar, i cili shkruan për Amëshimin dhe u vë data poezive. Ç'vlerë kanë datat e viteve, që për Amëshimin janë sekonda!

Sidoqoftë, ka një justifikim *suigeneris*. Frymëzimi lind në një çast për të jetuar pambarimisht.

Ky kalendar i duhet poetit për të dalluar radhën e frymëzimeve. Pra, ky është kalendari i vetë frymëzimit.

Dhe, pikërisht, në këtë vit, në vitin 2004, Moikom Zeqo ka skicuar më qartë se çdo herë tjetër emblemën e Poetit, sipas vizionit të tij.

Në këtë cikël ka edhe motive të tjera bashkë-shoqëruese.

Sigurisht! Nuk mund të përshkruhet portreti i Poetit i shkëputur nga bota që e rrethon, bota e mendimeve dhe e figurave emblematike shpirtërore!

Moikomi ia kushton ciklin filozofit Spinoza, por ai përmend edhe Budën, edhe Krishtin. Për një

çast është prezent edhe vetë Perëndia dhe, patjetër, Koha indiferente dhe e pamëshirshme.

Asgjë nuk ka për t'u çuditur.

Filozofi dhe Poeti janë vëllezër siamezë. I pari, me vështrimin nga bota e ideve. I dyti, nga universi i botës së artit.

Edhe metaforat e Moikomit janë, mbi të gjitha, metafora të mendimit. Vargjet e poetit janë "gjurmë në pllajën e mendimit", kurse poeti është "shtylla kurrizore e ideve". Gjithmonë sipas Moikomit.

Poeti është një "ndërgjegje e lirë endacake". Ai e quan veten e vet një "rishtar", një murg, që ka veshur zhgunin e ashpër të Poezisë.

Atë e ka bërë shkëmb "ikonografia prometeike".

Këto janë disa penelata, që skicojnë portretin e Poetit.

Historia e poezisë botërore njih disa portrete poetësh. Pikat e referencës së tyre janë të ndryshme. Një gjë është e përbashkët: konfliktualiteti i tyre me botën reale dhe me botën e mendimeve, me vetveten dhe me Kohën.

Konflikte këto, që janë zgjidhur në mënyra të ndryshme, në kohë po aq të ndryshme nga njëra-tjetra: Paramitologjike, Antikiteti, Mesjeta, Rilindja Europiane, Koha Moderne dhe ajo Postmoderne.

Në fillimet kemi Poetin Shaman, që fliste gjuhën

e idhujve;

Poeti i Antikitetit që fliste me gjuhën e zotave të Olimpfit;

Poeti Profet që fliste me gjuhën e Perëdisë së tërëpushtetshme.

Më pas kemi Poetin e larguar nga gjuha e Zotit dhe në konflikt me Të.

Konflikti me Kohën, me Jetën dhe me Vdekjen mbetet i përjetshëm.

Poetin e Moikom Zeqos e mundon konflikti më i fundit i Kohës Postmoderne, konflikti me globalizmin galopant gjithëpërfshirës, që synon edhe hapësirat kozmike.

Atë e mundon dilema sfilitëse, që lidhet me ralitetin tonë. Ai jeton në një botë të ashpër dhe të pamëshirshme, e cila, megjithëse është një botë përsosmërisht dhe teknologjikisht e zhvilluar, por është edhe një botë e cila po tjetëron shumë kode humane të jetës familjare dhe të asaj shoqërore, po e tjetëron (për keq a për mirë!) natyrën njerëzore, po e robotizon.

“Realiteti më grish për të më vrarë”, thotë ai.

Konflikti i tij intim është midis “shpirtit të druajtur” të kapluar nga jeta private, që kërkon “të qetësojë furinë racionale” dhe “fantazinë”, e cila e prin në të gjitha hapësirat”.

Moikomi sjell në vargje shembullin e filozofit Buruh Spinoza, që “lëmon lentën e mikroskopit dhe sheh errësirën/i mbetur krejt vetëm/në pafundësi” me “latinishten gjeometrike”, me “sindaksën e qartë” dhe me “simetrinë e konkluzioneve”, pa jetë personale, i përkushtuar i tëri pas filozofisë.

Ky poet është në konflikt, jo vetëm me vetveten, por edhe me vetë Zotin., “nuk ka nevojë për vizitat e perëndive”.

Për më tepër, ai është në konflikt edhe me vetë Kohën.


Për këtë poet, jo vetëm “poezia është një dashuri pa martesë”. Edhe “martesa” me Kohën, për të është, po të përdorim shprehjen e Pasternakut, “një martesë e dhunshme, prandaj edhe martesë e pashpresë”.

Zgjidhja e vetme frymëzuese, që i ka mbetur Poetit, është idea kozmike e pafundësisë, të cilën ai e kthen në metaforë të Përjetësisë.

Poeti i Moikom Zeqos, me intuitën e tij filozofike, shtron dhe argumenton poetikisht idenë mbi fuqinë e artit ndaj relitetit, mbi pavdekësinë e shpirtit poetik, që “kalëron me jele ankthi/dhe patkonj tipografikë”.

Miokom Zeqon e frymëzon mitologema e Pegasisit, kalit mitologjik me krahë, që rrahu me

patkonjtë malin e Helikonit, që po lartësohej drejt qiellit, e ndali atë dhe bëri që të shpërthejë prej dheut Hipokreni, burimi i frymëzimit universal, ku pi edhe Muza e Poetit tonë të jashtëzakonshëm.



SPROVA E VASIL VASILIT MBI STILIN E MOIKOM ZEQOS

Libri “Përkthimet e Kohës” (botim i West Print 2018) është një sprovë serioze, që autori Vasil Vasili ua shton krijimeve të shumta mbi shpalosjen dhe analizën e krijimtarisë shumëvëllimshë të krijimtarisë së Moikom Zeqos.

Në këtë sprovë Vasil Vasili operon me një qasje të vetën të menduar dhe të përcaktuar qartë. Ai ka shtruar në tavolinën e tij të punës planin e tij, i cili synon filozofinë krijuese të autorit në tërësinë e saj, përmbajtjen, formën, raportin e autorit me kohën, ose më mirë kohët, filozofinë në raport me të tashmen, të kaluarën dhe të ardhmen, raportin e autorit me gjuhën dhe estetikën. Ai na flet për kodet e poetikës së Moikomit, për administrimin e krijimit nga vetë autori dhe mbi leximin psikofizik të poezisë, të raportit të lexuesit me krijimin.

Vasili analizon mjetet artistike dhe prozodinë në tërësi, strategjinë dhe stilin poetik të poetit.

“Poezia e Moikomit, nënvizon Vasili, është një gramatikë e re poetike” dhe vetë Poeti është *“një përkthyes i madh”* i së kaluarës dhe konfigurues i së ardhmes; poezia e Moikomit ka një logjikë eklektike dhe ai vetë është *“një poet avangard”*.

Vasil Vasili na pohon të vërtetën se arti dhe vetë artisti i madh e tejkalon vetveten dhe erudicionin e tij. Moikomi bashkon mitologjinë, filozofinë, mistikën, shkencën, artin me indin e krijimtarisë së vet.

Unë po veçoj dy probleme, që më duken specifike të strategjisë krijuese të Moikomit.

Problemi i parë, i shtjelluar prej Vasilit, përcakton pikëpamjen filozofike të poetit. Ky lidhet me rimishërimin apo me idenë e pavdekësisë.

Problemi i dytë thelbësor lidhet me synimin madhor futurist të Moikomit, krijimin e një gjuhe globale metaforike.

Të dyja këto synime përbëjnë të veçantën dominuese novatore të krijimtarisë së tij. Këto nuk janë probleme të reja, të panjohura në fushën e letrave. E veçanta, apo e reja është se si i trajton dhe se si i zgjidh Moikomi.

Rimishërimi është koncept i filozofit të lashtë grek Pitagorës. Sipas Pitagorës, shpirti i përjetshëm lëviz nga qielli për te trupi i njeriut ose te trupi

i kafshës dhe pëson shumë rimishërime, derisa përsoset që të fitojë të drejtën të rikthehet në qiell.

Vasili pohon se poezia e Moikomit është shkruar mbi palimpsestin e kohës, që, e parë me syrin e studiuesit, do të thotë se ajo ecën në vazhden e krijimtarisë botërore, që nga fillimet e saj mitologjike e më tej. Ajo, pra, synon ta rrokë e ta bëjë të sajën këtë traditë shumështrësore.

Moikom Zeqo, si një erudit i paepur, i përtyp dhe i bluan, i filtron nëpërmjet penës së tij, duke i rishkruar me kaligrafinë e vet dhe sipas logjikës së vet eklektike.

Krijimtaria e Moikomit ka në themel konceptualitetin historik. Ai e bën të tijin këtë konceptualitet, e ridimensionon dhe i jep pasaportën për t'u rikthyer në "qiellin e artit" me një emër të ri.

Kjo krijimtari eklektike ka brenda tri dimensione: traditën e kaluar, është shkruar në çastin e sotëm dhe synon të ardhmen. Kjo më kujton shprehjen metaforike të poetit të madh futurist rus, Velimir Hlebnikovit: *"krijimtaria e vërtetë, e shkruar aktualisht, është një gur i së ardhmes, që ndez të tashmen"*.

Ky Trinitet është shenja zodiakale, që dallon krijimtarinë e Moikomit, në planin kombëtar, por edhe me synim global. Krijimtaria e Moikom Zeqos është një krijimtari sipërore dhe tani për tani,

vetmimtare në planin aktual kombëtar.

Synimi tjetër strategjik i filozofisë krijuese të Moikomit është krijimi i një gjuhe të përbotshme metaforike. Kjo lidhet me vendin që zë dhe rolin që luan gjuha në procesin krijues të poetit. Mbi këtë rol ka pikëpamje të ndryshme.

Josif Brodcki ka hedhur mendimin se *“poeti është mjeti i gjuhës, por jo gjuha mjeti i poetit”*, duke ia kaluar gjuhës atributin e Muzës antike. Kurse Robert Frost thotë se *“një emocion gjen mendimin dhe mendimi gjen fjalën”* duke pranuar edhe rolin e procesit krijues.

Studiuesi Vasili pohon se në krijimtarinë e Moikomit *“fjala ka logjikën e pavarur në krijimtarinë e poetit”*. Kjo e bën të mundshme ëndrrën e poetit për një gjuhë poetike të përbotshme. Një ide të tillë ka mbrojtur dhe synuar Velimir Hlebnikovi që në vitet njëzet të shekullit të kaluar.

Ky poet futurist mbronte idenë se gjuha e përbotshme do të krijohet nga shartimi i gjuhëve kryesore me njëra-tjetrën dhe duke synuar krijimin e fjalëve të reja nëpërmjet bashkimeve tingullore dhe semantike të fjalëve të vjetra, të sjella e të shartuara me gjuhën bashkëkohore. Ai synoi rikrijimin e Librit të Botës, që kap të gjitha lidhjet dhe ligjet e botës dhe, para së gjithave, ligjet e

kohës, gjë e cila do të thotë të kalosh nga e tashmja në të ardhmen, pa e fshirë të kaluarën.

Moikomi ka zgjedhur rrugën e vet për krijimin e një gjuhe globale poetike, gjuhë që na flet për të kaluarën e të ardhmen duke shfrytëzuar magjinë e fjalës.

Fjalës artistike nuk i mjafton kurrë vetëm një kuptim. Shumëkuptueshmëria e fjalës, pohon Elioti, është shenja dalluese e pozisë së vërtetë. Fjala ka burimin dhe rrugëtimin e saj. Fjala ka logjikën e pavarur nga poeti. Ajo është mpiksja e përfytyrimeve, është alkimia poetike e tij. Fjala është *"Toka dhe qielli i mendimit"* moikomian, nënvizon Vasili.

Moikomi synon, pikërisht, gjuhën magjike të metaforës, të mbretëreshës së figurave artistike. Vasili e studion dhe e argumenton bindshëm mekanizmin e krijimit të metaforës nga Moikomi.

Metaforat e poetit, na pohon ai *"janë thjerrza, që përthyejnë kohën historike për të ndriçuar kohën e genies. Ato plasën në kohën sot, në kohën e Poetit"*.

Metaforat e Moikomit janë, jo vetëm të larmishme dhe të papërsëritshme nga thellësia dhe mënyra e ngjizjes së tyre, ato janë etalloni i stilit të tij poetik.

Proza botërore ka personazhe që janë bërë

sinonim i emrit të autorit. Dramaturgjia ka monologje dhe konflikte lapidare. Tragjedia ka katharsin. Moikomi ka metaforën e tij fantastike emblemë të krijimtarisë së vet poetike. Studiuesi Vasili e quan atë “shenjë estetike” që bashkon “Koha sot” me “Ciklet e mëdha të kohëve” të së kaluarës dhe të së ardhmes. Metafora moikomiane e bën unik këtë palimpsest poetik të shkruar mbi trashëgiminë krijuese të kaluar të arritur deri në kohët tona dhe, në të njëjtën kohë, një projekt që poeti ia përcjell së ardhmes kulturore.

Metafora është miti e kulti i laboratorit krijues të Moikomit.

Duke u ndalur vetëm në këto probleme, pa synuar që të komentoj gjithë lëndën e pasur të kësaj sprove të shkruar me përkushtim dhe kulturë profesionale, me erudicion të spikatur, do të veçoja një kapitull të kësaj sprove interesante.

Ky kapitull mund të duket si një shmangie nga këndvështrimi estetik studimor, por ai mua më duket një deduksion logjik lidhur me psikofizikën e leximit të veprës letrare.

Çdo autori i intereson jo vetëm krijimi, por edhe çfarë ndodh me lexuesin, që e lexon veprën.

Studiuesi Vasil Vasili ka bërë një analizë model dhe një zbërthim konkret të strukturës së strofës


së Moikom, një koment analitik të saj duke synuar të tregojë konkretisht se si duhet lexuar poezia intelektuale e poetit.

Studimi i kësaj poezie mbetet një problem, jo vetëm studimor, por edhe një angazhim për ta përqsaur poezinë e Moikom me një lexues sa më të gjerë.

Poezia e Moikom është një optikë e re mbi jetën dhe botën. Si e tillë ajo mbart me vete edhe "kryqin" e saj, riskun e komunikimit me lexuesin.

Shpesh përsëritet se Moikomi shkruan për një lexues të ardhëm, për një epokë tjetër. Nuk besoj se Shekspiri apo Pushkini shkrojtën, jo për bashkëkohësit e tyre. Nuk ka autor që të mos etet për ta lexuar bashkëkohësit e tij, të mos e përjetojë këtë ëndërr. Duhej ta lexonte Getja, që të bëhej i përbotshëm Shekspiri. Duhej ta analizonte dhe ta vlerësonte Belinski, që Pushkini të bëhej poeti kombëtar i Rusisë.

Studime të tilla të thella, jo vetëm të studiuesit Vasil Vasili, por edhe të disa autorëve të tjerë të nderuar të përkushtuar ndaj krijimtarisë së poetit Moikom Zeqo mbi universin e tij krijues dhe mbi angazhimet konkrete më të thelluara mbi psikofizikën e leximit të veprës së Moikom Zeqos do të ndihmojnë në zgjerimin e rrethit të lexuesve inteligjentë të veprës së tij avangardiste.



LIRIZMI TOKËSOR I BEDUINIT KOZMIK

Kam shkruar disa shkrime për poezinë e çuditshme, të jashtëzakonshme, për fluturimet pindarike dhe metaforat fantastike të Moikom Zeqos. Po shkruaj dy fjalë për një diçka jo të zakonshme, për simbiozën e së madhërishmes me më të zakonshmen, simbiozën e abstragimeve filozofike me logjikën e thjeshtë jetësore, gërshetimin e “supermetaforave kozmike” me “minimetaforat tokësore”.

Shkak për këtë u bë leximi i vëllimit më të fundit “*I Padukshmi*”. Të paktën, mbase me vonesë e zbulova këtë të vërtetë! Ka edhe Kolombë të vonuar si emigrantët që po i zbulojnë sot kontinentet e botës, siç e zbulova unë në këtë moshë kontinentin amerikan! Çdo zbulim të ngazëllen, qoftë edhe i vonuar.

Duke lexuar këto poezi, m'u duk sikur, krahas një festimi madhështor në rrugët e qytetit nën tingujt e një simfonie bethoveniane, dëgjova

nga dritaret e shtëpive edhe tingujt baritorë të klarinetës së Laver Bariut. Dhe ishte e çuditshme se si shkriheshin në një miksim të padëgjuar hyjnorja e kozmikja me të përditshmen dhe tokësoren!

Krahas fjalorit kozmik, lexova fjalorin tokësor. Krahas emrave të planetëve, të heronjve mitologjikë, të stihive të natyrës. Krahas makro-toponimeve të Kozmosit lexova mikrotoponimet shtëpiake të mjedisit familjar: “oborri”, “mëllaga”, “rrënjët e kopshtit”, “ashensori”, “frigoriferi”, “rubineti i kuzhinës”, apo paisjet dhe takëmet e zakonshme shtëpiake: “abazhuri si vreshtë”, “ekrani i Tv”, “kremastari”. “rrobat e vjetra”, “syzet optike”, “tavlla me hi e cigares”, “gota e çajit”, “kruajtsja e dhëmbëve”, “galloshet”, lexova librin e shtëpisë: “gjyshja”, “nëna”, “babai”, “gruaja”, bile... edhe një “prift”, në vend të Prometeut apo të Krishtit!

M'u duk se Universi u ul, zbriti mbi Tokë. Si e nxuri Dheu Kozmosin në gjirin e vet aq të brishtë! Si mundi Moikomi, ky “beduin kozmik” (siç e quan veten në një poezi të këtij vëllimi) t'i përqsasë fluturimet pindarike me hapin e gamiles në dunat e saharës jetësore! Ja që ndodhka edhe kjo me Moikomin! Në parathënien e këtij libri ai e quan poezinë “apoteozë zhgënjyese” dhe Poetin “mashtrues të përjetshëm”, një “homo absconditus”

(person që i fshihet mëkatit).

Poezia e Moikomit, nga njëra anë harliset si “fantazmagori e të Paaritshmes” dhe një çast ajo zbret në tokë. A nuk ulet kështu edhe anija kozmike bashkë me kozmonautin, pas fluturimit! Dhe qenka një shtëpi e motshme, që “bie erë naftalinë” në Jug ku ulen perënditë dhe “hyjneshat” e artit! Gjyshja Faika “tund kanatën, e hapur të dritares, si marinari flamurin e sinjaleve, mbi anije, për të komunikuar me gjithçka, në det, në qiell dhe në tokë!”. Në atë shtëpi në Libohovë, në kopshtin e saj qenkan “rrënjët”, “prangat sakrale nën dhë”. Prangat e kujtimeve.

*“Tek këmbët e tua, - nënë, - ka rënë, - vetë Mona Liza,
- në gjunjë – dhe lutet – plot adhurim!
Dhe Shën Maria, - të vetmen, - që ti e besojë,
- kalon shpesh,
- tek ty, - vjen të të takojë, - pini – kafen e zezë, - me
aromë rozmarine, - Shën Maria flet, - kurse ti hesht, - e
mallëngjyer, - më në fund, - ajo të sheh me buzëqeshje –
filxhanin, - por në Amëshim, - s’ke më asnjë nevojë, - për
të mësuar, - të Ardhmen!”*

Edhe shpirtrat e të dashurve tanë nuk e harrojnë merakun për bijtë dhe zbresin në formë hijesh t’i bëjnë roje gjumit tonë të shqetësuar.

“...Ndërsa unë fle, i sfilitur, hija e babait, rri tek karrigia ime, në studio, pi duhan dhe kur bjen telefoni, e ngre receptorin, dëgjon me vëmendje dhe thotë, si me psherëtimë: „Më falni, i keni rënë gabim numrit!”

Jo vetëm Hyjneshat dhe Mona Lizat u bëjnë shoqëri nënave të mençura!

Edhe kolegët e mëdhenj nuk i zë gjumi. Duan të dinë apo vazhdojnë të marrin forma të reja nismat e tyre të guximshme në penën e pasardhësve të rinj!

“Borgesi i verbër mban në dorë librin tim të porsabotuar!”

Në poezinë avanguardiste të Moikom Zeqos “E Paarritëshmja bëhet e afërt dhe intime!” Këto ndodhin në poezitë - strofa, poemat, dramat e thella shpirtërore si në “Telefonata e gabuar”.

Dhe jo vetëm këto!

“Te vrimat e kopsave të xhaketës, më hyjnë dhe më dalin detet dhe planetët, e fantazmagorisë së gjithëpushtetshme, të metaforave!”

Po. Metaforat e “Bedunit Kozmik” Moikom Zeqo krijojnë vetëm çudira fantazmagorike!

NJË LEXIM I RI I METAFORËS

Në parathënien e botimit të tij më të fundit, “Laboratori i Ëndrrës” (2018) poeti Moikom Zeqo shkruan: “Ky libër shpegon Moikommin e tërë moshave. Pse kam shkruar ndryshe konceptualisht dhe estetikisht poezinë dhe prozën, serinë e librave të mi me stilin e pazakonshëm dhe të pangjashëm.... në kërkim të një lirike, të një stili absolutisht të lirë dhe të një improvizimi vizionar, që ka përparësinë e bekuar të metaforës”.

Kronologjia e memuareve të vitit 1970, të këtij libri, na flet mbi leximet, përkthimet, kontaktin me poezinë futuriste ruse, me poezinë europiane dhe atë amerikane, me sprovat të ndryshme krijuese, ushtrimin me figurat letrare dhe, kryesisht, me metaforat, interesimin mbi arkeologjinë tokësore dhe detare, hobin për pikturën, për muzikën, për njohjen e traditës më të përparuar letrare kombëtare etj.

Të gjitha këto, të dëshmuara në këtë libër, na hedhin dritë dhe na e bëjnë të qartë se përse

Moikomi ka shkruar ndryshe “konceptualisht dhe estetikisht poezinë dhe prozën”, na flasin për një personalitet erudit dhe aspak të zakonshëm krijues të letrave shqipe.

Sigurisht, të shkruash ndryshe nuk mjafton vetëm bagazhi dhe horizonti gjithëpërfshirës intelektual.

Të shkruash ndryshe poezinë kërkon jo vetëm zotërimin e arsenalit të saj krijues, të mjeteve bazë të mjeshtërisë artistike, por edhe një rivlerësim tërësor artistik dhe estetik të tyre, përpos zgjedhjes së mjetit më të përshtatshëm dhe adekuat për ta realizuar këtë qëllim.

Që në fillimet e krijimtarisë së tij poetike Moikomin e ka tërhequr figurshmëria e konkretisht alegoria dhe metafora.

Aristoteli është studiuesi i parë që e vlerësoi në shkallën më të epërme duke e quajtur metaforën “mbretëreshë” të tropeve. Pushteti dhe magjia e kësaj “mbretëreshë” qëndron, jo vetëm në bukurinë e saj estetike, por në thelbin e saj. Ajo, në dallim nga tropet e tjera, arrin një pasqyrim maksimal të së tërës, të mendimit dhe të ndjenjës, një rimishërim artistik të botës dhe të jetës njerëzore.

Figurat konkrete metaforike ekzistojnë në mënyrë të natyrshme. Ato i gjejmë në gjuhën

e përditshme në fjalë dhe shprehje nga më të ndryshmet. Ato përdoren, jo vetëm për ta bërë të folurën tonë sa më tërheqëse, por për të na e ngulitur kuptimin e tyre të figurshëm në kujtesën tonë. Ato janë, në radhë të parë, një fenomen gjuhësor me veti thellësisht emocionale mbresëlënëse.

Metafora ka historinë e përdorimit dhe të zhvillimit, interpretimit dhe pasurimit të saj, jo vetëm në sasi, por, mbi të gjitha, si cilësi artistike dhe estetike në poezinë botërore. Sipas mendimit fillestar, prodhimi i metaforave bazohet në sistemin e asociacioneve të pranuar nga të gjithë, ajo njihet mirë nga përdoruesit e gjuhës. Në kontekstin gjuhësor është i mjaftueshëm kombinimi metaforik që i jepet një fjale, një sendi, një ndjenje të figurshme.

Studiuesit amerikanë G. Lakoff dhe M. Jonson me veprën e tyre "Metaphors we live by" hodhën idenë se metafora është jo vetëm një dukuri gjuhësore por edhe mendore.

Ka edhe metafora që nuk kanë lidhje me sende apo objekte të realitetit. Këto metafora përfshijnë në vetvete koncepte kuptimore të sferës mendore. Këto janë metaforat konceptuale me kontekst kulturor.

Në kontekstin kulturor përfshihet kuptimi tërësor i diturive dhe i përvojës, i njohurive të

zotëruesit të gjuhës, në rastin tonë, të vetë poetit. Metafora bëhet kështu jo vetëm mjet i formimit dhe i objektivizimit të tablosë konceptuale të botës, por edhe paraqitja verbale e saj nga poeti. Ajo zotëron tiparet e qarta të ndërgjegjes vetjake të krijuesit të saj.

Moikomi e bëri metaforën konceptuale “pegasin” e muzës së vet, jo rastësisht dhe jo spontanisht. Në librin e tij “Laboratori i ëndrrës” na tregon me shembuj se kush ndikoi te ai në këtë përzgjedhje.

Mësimet e para ai, sigurisht, i mori nga gjuha e gjallë e popullit të vet. I mori nga leximet e poetëve tanë të shquar: De Radës, Naimit, Lasgushit, Migjenit, poezinë e të cilëve, jo vetëm e lexoi, por edhe e studioi.

Burimi kryesor për të ka qenë poezia futuriste. Ai na e dëshmon këtë me shembujt si dhe me përkthimet-prova nga kjo poezi. Dhe konkretisht nga Majakovski. Ai bëri të tijën figurshmërinë hiperbolike, detajet tokësore, konkrete apo abstrakte të paralelizuara metaforikisht me fenomene të natyrës, frymëmarrjen kozmike të poetit më të shquar futurist të dekadës së parë të shekullit të njëzet.

Ai na pohon, gjithashtu, për ndikimin e poetit

francez Pierre Reverdy, stili i të cilit ka jo vetëm ngjyrim mistik, por edhe një *“lartësi të thjeshtë të pasqyrimin të realitetit”*.

Një ndikim të padiskutueshëm në krijimtarinë e tij ka mitologjia greke me metaforat e saj të perëndive të Olimpmit. Atë e kanë tërhequr metaforat mitologjike të perëndive të Olimpmit të veshura me vetitë njerëzore, si dhe stili metaforik i odeve të poetit të madh të lashtësisë antike greke, Pindarit dhe, sipas meje, ajo që studiuesit e poetit antik e kanë quajtur *“rocky stream of eloquence”*. Duke patur parasysh, motërzimin mitologjik të Uranias (Muzës së Astronomisë) me Euripinë (Muzës së Poezisë) Moikomi, siç shprehet vetë, realizon poetikisht *“Qiellëzimin e Poetikës tokësore dhe Tokëzimin e Kozmologjisë”*.

Te Moikomi gjejmë edhe ndikimin e besimeve të mëvonshme, pas antikitetit, të cilat mistifikuan Zotat dhe Heronjtë, nga metaforat biblike dhe, veçanërisht, nga botëkuptimi panteist bektashian. Ndërsa studiuesi Fatmir Minguli pohon se metaforat e Moikomit *“vijnë nga legjendat shqiptare”*.

Sigurisht, metaforat kanë shumë burime. Janë jo vetëm burimet historike. Mbi të gjitha, ato burojnë nga jeta dhe realiteti i përditshëm.

Metaforat konceptuale klasifikohen në grupe

të ndryshme sipas idesë: “njeri - natyrë”, “njeri-dashuri”, “njeri-vdekje” etj. Ndër më të preferuarat nga Moikomi janë ato me temën “njeri-jetë”.

Poeti, si çdo qenie e gjallë, e heton botën me anë të pesë shqisave: të të parit, të të dëgjuarit, të të prekurit, të nuhaturit dhe të shijuarit. Unë po ndaloj te shqisa e pestë, më delikatja dhe më estetikja, në të shijuarit e jetës, të botës materiale dhe asaj shpirtërore.

Moikomi ka shkruar një cikël të tërë me titullin “Shqisa e pestë”.

Fokusi i këtyre metaforave, të përzgjedhura prej meje, është bota shpirtërore, vetmia universale, vdekja, pra, modeli “njeri-jetë”. Secila nga këto tri metafora ka idenë, krahasimin dhe analogjinë metaforike, ka strukturën e vet.

Le t'i lexojmë këto.

* * *

1.Ç’është ky shekull, që mban në duar kryqin, si kyçin e ndërtimit të Vetmisë sonë universale?

Kemi një metaforë konceptuale mbi një dukuri dramatike aktuale, mbi Vetminë Njerëzore. Kjo metaforë, nga një “objekt” abstrakt, është personalizuar, “materializuar” (ajo ndërtohet),

ndërtuesi, “mjeshtri” i saj është Shekulli (një nocion kohor, i animizuar edhe ky) që mban në dorë Çelësin e kësaj “kulle ngujimi”.

Poeti na e rilind konceptualisht metaforën e konsumuar të Mjeshtrit (muratorit) duke na e kthyer pas në origjinën e mitit të Vetmisë. Ai rikrijon kështu metaforikisht njëjësimin e ri dramatik të Botës me destinin. Kjo metaforë mishëron konceptin e ndëgjegjes poetike mbi këtë dukuri aktuale globale të formuluar artistikisht si një pyetje retorike mbresëlënëse.

* * *

2. Duhet njëqind herë Ferrin i gjallë ta kalosh, që më në fund të vdesësh në paqe si njeri!

Metafora e dytë është e veshur me petkun e hidhur të cinizmit tragjik (të vdesësh në paqe duke vuajtur) duke kaluar nëpër Ferr. Ferri nga koncept biblik fetar merr atributet e jetës tokësore, e mundimeve dhe vuajtjeve njerëzore, duke u shndërruar kështu nga një koncept abstrakt biblik, në një realitet tokësor ku vdekja dhe paqja e përjetshme janë shpëtimi. Kjo metaforë konceptuale vjen si rezultat i njohjes së kalvarit të jetës tokësore dhe të adhurimit të dinjitetit njerëzor, duke

pasqyruar kështu ndërgjegjen individuale të poetit. Ky fakt bëhet kështu përcaktuesi i pikëpamjes gjuhësore, që realizohet në dy drejtime.

Nga njëra anë na jepet një tablo reale poetike e botës dhe nga ana tjetër na krijon metaforën e modelit “njeri-jetë”.

* * *

3.Dhe lëvizja e mendjes është fryma e shpirtit që fryn trumbetën e artë të Zgjimeve të Mëdha!

Metafora e tretë është një produkt që ka në bazë dy dukuri të kundërta, botëkuptimin fetar dhe konceptin materialist biologjik, gjykimin dhe frymën.

Të dy, “mendja” dhe “shpirti” animizohen. Mendja “lëviz”. Shpirti “merr frymë”. Shpirti, që “me trumbetën e artë” lajmëron profecinë e Apokalipsit, nëpërmjet metonimisë “mishëron” Kryeëngjëllin biblik. Paradoksale!

Përqasen logjika materialiste me konceptin idealist! Dhe jo vetëm kaq. Është logjika tokësore që frymëzon logjikën qiellore!

Volteri frymëzon Kryeëngjëllin që t'i bjerë trumbetës së fitores biblike!

Metafora konceptuale e pranon bashkëjetesën

e racionales me iracionalen, të mitologemës me historiken.

Metafora (bashkë me motrën e saj, metoniminë) krijon hapësira të pafundme mendimi dhe bëhet më shumë se mbresëlënëse.

Kjo është një përparësi tjetër “e bekuar” e metaforës konceptuale.

Studjuesi Vasil Vasili ka përcaktuar me mençuri një veti të rrallë të poezisë së Moikomit. Ai na shkruan se kjo poezi “është e elektrifikuar në qelizë”.

Kjo “qelizë e elektrifikuar” është Metafora Konceptuale.

Metaforat konceptuale të Moikom Zeqos mishërojnë artistikisht tërësinë e ndjenjave, mendimeve dhe përvojën e pasur gjuhësore dhe kulturore të vetë Poetit, këndvështrimin e tij mbi botën, mbi jetën dhe vdekjen, mbi abstrakten dhe konkrete, mbi të bukurën dhe estetiken.

Poezia e Moikom Zeqos është një kaskadë metaforash konceptuale me anën e të cilave

Poeti na rikrijon artistikisht tablonë e botës materiale dhe asaj shpirtërore të shekullit tonë.



NJË SHËNIM MBI STROFËN E MOIKOMIT

Çdo shkrimtar i shquar ka raportin e vet me gjuhën, stilistikën figurative dhe me formën grafike të realizimit të veprës. Secila prej tyre ka rolin, funksionin, domethënien dhe peshën e saj. Në këtë shënim po ndalem, kryesisht, në formën grafike të poezisë së Moikom Zeqos.

Strofa, kjo formë e paraqitjes grafike të frymëzimit poetik, është më e parapëlqyera prej tij. Kjo nuk është një strofë e zakonshme poetike, e cila, zakonisht, është njëra nga gjymtyrët përbërëse të arkitekturës grafike të një poezie. E shkëputur nga strofat e tjera, ajo e humb peshën dhe vlerën e saj.

Strofa e Moikomit është një njësi poetike e pavarur, e plotë dhe e mbyllur. Ajo i merr mbi vete të gjitha atributet dhe detyrat e ligjërimit artistik e estetik si një krijim poetik i përfunduar. Strofa ka frymëmarrjen e plotë të frymëzimit. Ajo ka një numër të pakufizuar vargësh. Mund të jetë një

varg i vetëm, ose dy, tre e gjashtëvargëshe. Kjo është forma grafike tipike e poezisë së Moikom Zeqos.

Kjo strofë poetike është e një lloji krejt të veçantë, e paparë ndonjëherë më parë në poezinë tonë, jo thjesht për formën e saj grafike, por për mënyrën e funksionimit të saj artistik dhe estetik, të lidhjes që kanë në mes tyre vargjet si dhe të produktit artistik që përftojnë.

Në strofën tradicionale vargjet i lidh dhe i komponon si tërësi metri, rima dhe ritmi; kurse, në poezinë me varg të lirë, kryesisht, ritmi.

Në strofën e Moikomit, vargjet lidhen ndërmjet tyre jo falë rregullit gramatikor, por kuptimit të veçantë të stilit të autorit. Ato i lidh, në radhë të parë, sistemi i shënjave, simboleve dhe mitologemave, leximi dhe kuptimi i tyre sipas interpretimit që u bën autori.

Moikomi shkruan: “Kanjë rubinet të imagjinatës, nga rrjedhin rrufetë në kuzhinat gotike, ku piqen bukët e poetëve”. Ai ka “kuzhinën” e vet. Strofa e Moikomit nuk ka as rima, as asonanca, përputhje të plotë apo të përafërt rrokjesh, sipas metrikës klasike. Rima e strofës së Moikomit është e një natyre krejt tjetër. Ajo është e veçantë dhe novatore. Unë do ta quaja “konceptuale”, si edhe

metaforën e tij. Në qoftë se në poezinë metrike rima ka funksionin e kujtesës dhe të lidhjes së vargut të mëparshëm me vargun pasues, Moikomi e ka zëvendësuar atë me një “rimë” të një lloji krejt tjetër. Funksionin tingullor dhe atë grafik, që lidh vargjet e strofës ai e ka zgjidhur në një mënyrë novatore. Ky novacion i shkon modelit të poezisë konceptuale që parapëlqen poeti. Kjo “rimë vargore” lidh dhe bashkërendon konceptualisht dhe estetikisht mendimet e vargjeve, ose, më saktë, i fqinjëson ato midis tyre, duke i rimarrë dhe thelluar më tej në vargun pasardhës nëpërmjet figurave stilistike, kryesisht të shenjave simbolike me një veshje aforistike, nëpërmjet vargjeve të goditura me fuqi shprehëse, të cilat përmbajnë një mendim të përgjithësuar të nxjerrë nga jeta.

Edhe ritmi i kësaj poezie shkon paralel me simotrën e vet, rimën. Ritmi i vargut pulson në vartësi të ngarkesës psikologjike që ai mbart në vetvete dhe aspak në vartësi të theksave tradicionale metrikë.

Energjia artistike dhe estetike e vargut të Moikomit, nuk është aspak harmonia dhe delikatesa e shprehjes, melodioziteti i vargëzimit. Atë e zëvendëson tensioni psikologjik i frymëzimit. Energjia e tij është “radioaktiviteti mendor”, siç e

pohon edhe vetë poeti. Ai ngre pyetje, polemizon, profetizon. Vargu i tij “harliset si fantazmagori e të Paarritshmes”.

Moikomi e pranon hapur se preferon “ekstravagancën”, të jashtëzakonshmen, por jo paqrtësinë, pakuptueshmërinë. E pranon “estravagancën e metaforës” në funksion të një ideje të kuptueshme. Në këtë strofë një rol të caktuar luajnë edhe pauzat brenda vargut, të cilat rregullojnë frymëmarrjen e strofës dhe të vetë frymëzimit dhe shënohen me vijzë (-) ndërmjet çdo togfjalëshi: *“Poetët e lenë – Fantazinë e tyre, pas Vdekjes, - nën Kujdestarinë e yjeve!”*.

Por më e rëndësishme për Strofën e Moikomit, është pauza, ndalesa midis vargjeve. Pauza midis vargjeve i ngjan një fuqie mistike që i shndërron si me magji pamjet, situatat, emocionet, deduksionet, shënjat. U vesh atyre magjinë dhe sharmin mitologjik. Kjo pauzë është e një natyre tjetër nga ajo e pazës klasike.

Në poezinë dyvargshe, *“Thika e Kainit”*, për shembull, kemi vetëm një pauzë të tillë. Ajo është një pauzë psikologjike, heshtje meditative. Vargjet e kësaj strofe ngjajnë si fraza të ndërprera të një dialogu tragjik. Poeti, pasi ka hedhur argumentin kryesor të poezisë, (krimin biblik), i le kohë vetes

dhe lexuesit ta vlerësojë atë:

“E hodhi Kaini thikën e përgjakur!”.

Ndodhia biblike personalizohet dhe animizohet, vlerësohet stilistikisht:

“thikës i dolën krahë dhe me vërtik nga qielli gjuan si prehë vetë njerëzimin”.

Në optikën e stilistikës së poetit, ndodhia biblike e vëllavrasjes, kjo mitologemë, rivlerësohet hiperbolikisht. Ajo jo vetëm evidenton, por edhe emocionin. Ajo kalon në një rrafsh tjetër, e zgjeron dhe e përgjithëson në rrafshin shoqëror dhe historik, në një kasaphanë të luftës botërore.

Në poezinë elegjiake, *“Qeniet Njerëzore Gëlltitin Përjetësi”* pauzat janë të natyrës thellësisht intime. Kemi një meditim, një mall:

“Brenda meje ka rrugë, ku ti ecën e vetme, e dashur!”.

Dhimbja është e vjetër, por jo e platitur. Ajo e shtyn heroin lirik qetësisht të arsyetojë në mënyrë aforistike:

“E vërteta tingëllon nga brenda, jo me dukjen e gjërave!”.

Në vargun e tretë ai i kthehet kujtesës së shpirtit të vet:

“Në zgaorat e Kujtesës ka shumë pasqyra”.

Përsëri një pauzë, një psherëtimë ngushëlluese, përmbyllëse e strofës e cila me ton elegjiak i jehon në shpirt. Kitaristi gjenial, i vdekur edhe ai, kthehet në simbolin e përgjithësimit dhe përjetësimit të dhimbjes tragjike të heroit lirik:

“Dhe mbi kitarë Xhimi Hendriksi telin më tingëllues vuri gjarprin e Edenit!”.

Vini re! Sa virtuoze është mjeshtëria e Poetit në përdorimin e shenjave, simboleve mitologjike dhe jetësore kur gërsheton jetën reale me atë metafizike. Çfarë forcë emocionale merr pauza midis vargjeve! Sa natyrshëm vjen ajo! Edhe titulli i poezisë bëhet një varg i strofës” “Qeniet njerëzore gëlltitin përjetësi”.

Pauzat e poezisë së Moikomit duhen “lexuar” me më shumë kujdes se sa fjalët e saj. Pauzat, heshtjet e poezive të tij erudite shprehin aspiratat e ndjenjave dhe të mendimeve të thella, të cilat

shpesh janë edhe të sofistikuara.

Një rol të veçantë grafik luan edhe titulli i secilës strofë.

Ai është “busulla” orientuese për shtegtimin e lexuesit nëpër labirintin e këtyre vargjeve, është “filli i Arianës” për të dalë nga “shpella” e simboleve, mitologemave dhe metaforave konceptuale të Poetit.

E parë dhe e vlerësuar në këtë mënyrë, kjo lloj strofe është veshja më e përshtatshme e frymëzimit dhe e filozofisë krijuese të poetit, e këtij personaliteti dhe krijuesi të jashtëzakonshëm.

Mirëkuptim i poezisë nuk do të thotë, thjesht, të lexosh e të kuptosh vetëm fjalët e saj.

Duhet të kuptosh e ta ndiesh thellësinë dhe delikatesën estetike bashkë me erudicionin e saj. Kjo do një kulturë, do njohuri të caktuara poetike.

Poezia e Moikomit nuk është një poezi e thjeshtë.

Ajo synon artin e madh bashkëkohor. Ajo nuk lakmon aspak numrin me shumë shifra të lexuesve.

Ajo i drejtohet lexuesit që e mirëkupton. Dhe ky lexues nuk i ka munguar aspak Moikomit! Ai vjen duke u shtuar çdo ditë.

Lexuesi inteligjent i ardhshëm do ta shijojë dhe vlerësojë plotësisht talentin e tij *sui generis*, të jashtëzakonshëm.



VEGIMTARI QË RINDËRTON NJË RALITET TË RI

1. Në të gjitha kryeveprat e letërsisë botërore e gjejmë të mishëruar idenë e një realiteti të ri, të një morali dhe arti që e kapërcen kohën e vet. Edhe vetë filozofi gjerman Hegeli e ka pohuar idenë se arti është morali i shoqërisë së ardhme. Rindërtimi i një realiteti të ri është një mision filozofik, sociologjik, artistik dhe estetik, mbi të gjitha, një projekt human, i cili nuk është aspak një anatëmë ndaj shoqërisë së kohës së vet, por projekt i perspektivës dhe i aftësisës së vetë shoqërisë njerëzore drejt një hapi të ri të panjohur më parë.

Në një intervistë të vitit 1998, Moikom Zeqo shprehet: *“...unë kam një mendim të përcaktuar mbi botën dhe ky mendim i përcaktuar i imi, ndoshta nuk përputhet me këtë shoqëri që jetojmë sot”*.

Moikom Zeqo ka krijuar një korpus solid i cili ka sjellë një brendi dhe një filozofi të re krijuese në historinë e letërsisë kombëtare.

Tipari kryesor i saj është kozmogonia poetike

e cila nënkupton përvetësimin artistik dhe reformimin e realitetit. Në themel të saj qëndron metafora konceptuale e cila ka aftësinë të krijojë një realitet të ri, duke vënë përballë koncepte jo adekuate semantike të gjykimit njerëzor. Nga kjo përballje konfliktuale përftohet një gjykim i ri dhe njohuri të reja mbi botën që na rrethon.

Moikomi vë përballë dukuri të jetës me ato të natyrës, të botës konkrete dhe të asaj abstrakte, të realitetit konkret dhe të atij metafizik, të së tashmes me ato të së kaluarës dhe të së ardhmes, të jetës tokësore me atë kozmike, të ëndrrës me zhgjëndrrën, një kozmogoni poetike fantastike e jashtëzakonshme nga e cila përftohen perceptime krejt të reja mbi jetën dhe botën, një moral dhe një përfytyrim krejt i ri, një univers i ri poetik i paparë më parë në poezinë tonë.

Siç pohon Moikomi në intervistën, që përmenda më lart, ky vizion nuk është aspak mistik, nuk mund ta emërosh lehtë me një term të huazuar nga filozofia, nuk është aq i shpjegueshëm deri në fund, është, siç e përcakton ai “një lloj panteizmi i brendshëm shpirtëror i artit”.

Vepra letrare është kështu një përvetësimi artistik dhe riformim i realitetit. Motivi kryesor mbetet ndërgjegjja krijuese dhe vetëdija e misionit

vegimtar mbi rolin mesianik të poetit dhe të poezisë. Ky mision ka qenë dhe mbetet gjithmonë i tensionuar dhe në konflikt të pashmangshëm me realitetin aktual. Në letrën shkruar Vasil Vasilit në vitin 2006 ai shkruan: *“Poezia burimsohet nga kriza. Jashtë krizës nuk ka Poezi. Pakënaqësia lind vizione të mëdha”*.

Poezia e shkruar në vitet '70 i solli shqetësime serioze Moikomit, “ e dëshpëroi” siç shkruan ai. E bëri atë që të heshtë për një kohë. Akuza zyrtare ishte “hermetizmi”. Që desh të thoshte mospranim i metodës zyrtare të realizmit socialist.

Mospajtimin e tij me gjykimin e kohës Moikomi e shpreh qartë në intervistën e vitit 1998: *“Kontradikta ime qëndron midis pozicionit që unë mbaj, nga thelbi i popullit, me “elitën” politike” dhe shton: “sepse unë jam ai që jam, sepse unë nuk dua të jem ai që më duan të tjerët”. “Poezia që kam shkruar në vitet '70 të shekullit të kaluar ka qenë liria ime për të tjerët”*. Sfida e Moikomit për një porjekt të një realiteti të ri ka filluar herët!

Cili është realiteti i ri që mëton Moikom Zeqo të na krijojë me kozmogoninë e tij poetike?

2. Krijimtaria poetike e Moikom Zeqos është një akt i krijimit të një realitetit të përfytyruar. Për

ta përcaktuar dhe përkufizuar këtë po nisem nga koncepti bazë filozofik dhe estetik i kësaj krijimtarië, i cili, sipas meje është: Poeti dhe Universi.

Ky koncept ka parasysh lidhjen e ngushtë midis Makrokozmosit dhe Mikrokozmosit, midis Gjithësisë dhe Njeriut.

Njeriun si mikrokozmos e gjejmë si në filozofinë antike edhe në poezinë e shekullit tonë, sigurisht, të rilindur. Vendosja e njeriut në qendër ndihmon në interpretimin e çdo lloj dukurie, shoqërore, natyrore dhe kozmike.

Duke e pranuar këtë tezë, pohohet dhe shpjegohet edhe veprimi tjetër, ai i rikrijimit të realiteti të ri në krijimtarinë poetike. Duke e paraqitur këtë si një ndërlidhje dhe vazhdimësi të mitologjikes në realen e sotme.

Këtë na e dëshmon më së miri dhe krijimtaria e Moikom Zeqos.

Ai shkruan:

*“Poeti e ka
Si oshëtimë në trup
Imagjinatën e mbyllur
Dikur, në një amforë zotash!”*

Ai guxon ta ndjejë veten të barabartë me Demiurgun: *“ndiej energjitë e magjepsura Të Krijimit!”*. Dhe është i bindur se *“poetët projektojnë Njerëzimin e Ri!”*.

Po të ndalonim deri këtu, do të kishim të bënim me një projekt romantizant. Të rikrijosh realitetin e ri të premtuar, do të thotë të rishikosh edhe stereotipet religjioze, t'ia përshtatësh ato epokës.

Siç përmenda më lart, Moikomi nuk është aspak mistik, por, në të njëjtën kohë, thotë se e ka të vështirë të përdorë një term të saktë filozofik. Dhe kjo është e vërtetë. Ai nuk beson në një Zot. Por, nga ana tjetër, vazhdimisht përmend Krishtin dhe na e sjell si shembull frymëzues në ligjërimin e tij.

Ky pozicion më sjell ndër mend Naim Frashërin, poezinë e tij *“Përpara Krishti”*, na jep figurën e një martiri të vërtetë për hir të idealit të tij fetar. Moikomi, në parathënien e librit *“Golgotë Fluturash”*, që na flet me admirim për këtë martir të besimit dhe pikërisht për atë që Krishti sakrifikoi anën njerëzore për të ruajtur shenjtërinë e tij.

Moikomi është ateist, por ai është *“një shenjtor i artit”*.

Për artin është gati të sakrifikojë gjithçka, përveç Shenjtërisë së Krijimit!

Mbi të gjitha ai vë sublimimin e Poezisë si art i

madh i rikrijimit të një realiteti të ri. Ky është sfondi i mirëfilltë filozofik dhe filozofia e kozmogonisë së tij poetike.

Ndërsa sistemi figurativ dhe mjetet e gjuhës artistike, që përdor Poeti, përbëjnë sistemin estetik të këtij projekti për rikrijimin e ralishtit të ri vegimtar.

Me një sistem figurash të konsumuara dhe me një ligjërim poetik të vjetëruar nuk është e mundur të vihet në jetë një program i tillë avangardist.

Për kam shkruar më lart.

Tropi kryesor artistik që përdor Moikomi, tropi magjik i tij është Metafora Konceptuale.

Nuk po hyj në hollësi të tjera. Çdo metaforë e tij është si *“Gishtëja, - që jeton, - bëmat e një Gjigandi!”*. Do të shtoja vetëm një gjë të re, që nuk e kam thënë. Për energjinë e lartër të ligjërimin moikomjan. Po bëj një paralele, mbase, të çuditshme.

Ajnshtajni, në vitin 1905 shpalli botërisht formulën magjike kozmike: $E=mc^2$, ku rolin vendimtar e luan shpejtësia e dritës (c^2).

Të flasësh për një projekt universal të rindërtimit të një realiteti të ri pa një “energji” të re, më e pakta, është një utopi e vjetëruar.

Kjo energji e re është Fantazia Universale Moikomjane, janë “Inteligjencat e fshehta të

Fjalëve”, “gjaku” i ligjërit të tij poetik, që ka “Molekula Planetët”.

“Lexomëni, ju lutem ! Që nga ky çast do t’ju bëj të mendoni ndryshe, - krejt ndryshe ! Amen !”



ABSTRAKSIONI, IMAGJINATA - SI RIKONCEPTIM I GJUHËS POETIKE

Kam në duar botimin më të fundit të poetit Moikom Zeqo, “Golgotë Fluturash”, (botim i WEST PRINT 2019) i cili, jo vetëm na hedh dritë mbi rrugën nëpër të cilën ka ecur krijimtaria e poetit, por edhe novacioni, që ka sjellë krijimtaria e tij në historinë e poezisë sonë bashkëkohore.

Krijimtaria poetike e Moikom Zeqos është jo vetëm një krijimtari e kompletuar e nivelit të epërm artistik, por, mbi të gjitha, modeli i një rikonceptimi të gjuhës poetike.

Në Parathënien e librit të tij Poeti shkruan: “Duke e riparë librin tim laboratorik “Golgotë fluturash”, të poezive të harkut konvencional kohor 1991-1999, kam ndjerë në mungesë shekujsh praninë ngulmuese të Atij,- që ndali në Golgotë ku iu shkatërrua “natyra njerëzore” .- për të mos i humbur “natyra hyjnore”. Alegoria historike dhe ajo metaforike janë të qarta: privacionet politike të kohës nuk ia vranë poezinë.

Ky “palimpsest” i rizbuluar rishtas na flet qartë për këtë. Vetëm e vonuan botimin,- por jo mesazhin. Vetëm ndaluan komunikimin e poetit me lexuesin dhe, gjithashtu, e pamundësuan komunikimin e mesazhit avangardist të kësaj poezie moderne në botën e letrave shqipe.

Është e njohur aksioma se procesi krijues i vërtetë njihet dy etapa të rëndësishme që janë: “abstraksioni dhe imagjinata nëpërmjet të cilave gjuha e zakonshme rikonceptohet dhe merr emrin “gjuhë poetike”. Rrymat e ndryshme kanë qasje të ndryshme ndaj këtyre. Realizmi klasik pranon Realen dhe aspak Abstrakten. Impresionizmi botën reale e kalon nëpër filtrin e ndërgjegjes së krijuesit duke e lidhur me ndijimet dhe me mbresat e poetit. Abstraksionizmi e shmang paraqitjen e realitetit duke vënë në plan të parë ndërgjegjen dhe vështrimin vetjak të botës.

Krijimtaria e Moikom Zeqos, sipas mendimit tim,- mund të klasifikohet si një krijimtari avangardiste, pa e etiketuar me epitete të ndryshme. Ajo i ka të pranishme etapat e procesit krijues, edhe abstragimin, edhe impresionin, edhe imagjinatën.

Nobelisti Josif Brodski shkruan: “Poezia është abstragim i prozës, i jetës, i ndjenjës, i shpirtit, abstraksioni është shkëputja, veçimi i më të mirës

gjatë procesit të njohjes i anëve jo thelbësore, të vetive, të lidhjeve me qëllim që të dalin në pah tiparet objektive thelbësore”.

Abstragimi vë në plan të parë ndërgjegjen dhe vështrimin individual mbi botën. Këtë të vërtetë të procesit krijues e pohon edhe Moikomi:

*“Në Universin e modeleve dhe të formave
Shpirti zgjedh diçka,
Për të mos firaksur Përmbajtjen!”*

Poezia e Moikomit e shmang përshkrimin e detajuar, jo vetëm të sendeve apo të meditimeve dhe të ndjenjave, të panoramave të natyrës, ai e shpreh hapur devizën e tij: “S’ më prekin detajet e përditshmërisë”.

Ai abstragon detajet, abstragon veprimet, abstragon proceset biologjike duke arritur në deduksinë “abstrakte” për logjikën normale analitike:

*“Ah, të abstragosh lopën,
Për të nxjerrë prej saj qumështin,
Dhe të abstragosh qumështin,
Për të krijuar sërish barin e gjelbër “*

(e thënë në mënyrë prozaike: lopa ushqehet me

bar dhe na jep neve qumështin).

Gjuha e zakonshme është gjuha e komunikimit të zakonshëm njerëzor.

Gjuha poetike është gjuha e abstragimit artistik, gjuha e perceptimit estetik të figurshëm të botës, gjuha e zbulimit filozofik të fenomeneve, e mendimeve dhe ndjenjave të thella:

“Proza rengjethet

Para Poezisë,

Si Kali i Zi

Përballë Gjarpërit të Artë!”

(“Qëndizma në petkat e hyjnive”)

Është e vërtetë se abstragimet nuk kapen dot dhe nuk pëlqehen nga të gjithë, se duhet jo vetëm një kulturë e gjerë, por edhe një shije estetike e kultivuar. Procesi i abstrakcionit dhe i zbulimit estetik është një proces progresiv civilizues, që arrihet nëpërmjet përgjithësimit mendor, në radhë të parë.

Është e rëndësishme të përcaktohet kufiri midis abstraktes dhe absurdes. Në qoftë se absurdi është një dukuri pa kuptim, jashtë llogjikës, abstraksioni shkon krahas me imagjinatën, që është pjellë e mendjes e cila përfytyrohet si një e vërtetë e gjykimit.

Në ridimensionimin, rikonceptimin e gjuhës poetike të Moikom Zeqos luan një roj jashtëzakonisht të rëndësishëm edhe imagjinata.

Imagjinata e poetit është një aspekt i zbulimit poetik, e cila e transformon brendinë e poezive të tij duke e mbushur atë me përfytyrime poetike të njëmendta, ajo është në themel të krijimtarisë së tij.

Metafora e Moikomit është pjella e imagjinatës së tij të çuditshme. Ajo lind nga shkëndija e intuitës së tij të veçantë, që ndriçohet nga tensioni i tij krijues i jashtëzakonshëm.

E KREMTJA E MADHE E SHQIPONJAVE

*Vërtitet mbi mua
Era sferike,
Plot spica dhe gjemba.*

*Ca gonxhe trëndafili
Cicërojnë
Si harabela të Ilirisë antike.*

*Qëroj luspat e Hënës peshk
Dhe luspat
Dritësojnë planetin.*

*Një histori e re botërore
Rri pezull në qiell,
Por s'e lexon askush.*

*Dhe Dielli bekon
Të Kremten e Madhe
Të Shqiponjave!*

Kjo poezi e shkruar në vitin 1991 është një shembull tipik i fluturimeve të poetit në të kaluarën, në të tashmen dhe në vegimet e së ardhmes. Kemi në të edhe gonxhen e trëndafilin, dhe arabelat e Ilirisë antike, edhe "Hënën peshk" edhe Diellin tok me "erën sferike", një kozmogoni poetike; kemi metafora, krahasime, kemi epitete, kemi simbole.

Kemi dhe një Traditë dhe një Risi. Këtë temë rilindasit tanë e patën shprehur thjesht:

*"Shqipëria gjallë ka qenë?
Që kur Bota është zënë".*

Moikomi e rimerr këtë imagjinatë romantike duke e shpalosur në përmasa universale të kontrolluara dhe të arsyetuara me logjikën e perceptimit kozmik të lëvizjes planetare duke e mbushur me përfytyrime konkrete metaforike (era

sferike, Hëna peshk, Dielli); era është shqetësuese, Hënës ia heq luspat, që e mbulojnë dhe s'e lejojnë të ndriçojë, Dielli merr rolin e perëndisë që bekon, zgjohen nga gjumi shekullor dhe cicërojnë si harabela kujtimet e lashta ilire, të gjitha janë brenda një llogjike të arsyetuar abstraguese.

Imagjinata është jo vetëm nxitja dhe fillimi i frymëzimit poetik, por përbën edhe themelin e gjithë poezisë, që mbyllet me ëndrrën e madhe kombëtare, që rri pezull ende dhe “s'po e lexohet”.

Çdo abstragim poetik ka një ose më shumë interpretime. Edhe vetë Moikomi thotë:


*“Jam vërtet një shaman plak, i harruar,
Por s'shpjegoj dot
As poezitë e mia!”*

Dhe po vetë i përgjigjet këtij arsyetimi të pashpegueshëm:

*“Poezia
Është Anatomia e Shpirtit!”*

Kurse Brodski thotë: *“Poezia është abstragimi i shpirtit”*.

Shpirti mund të “mishërohet” vetëm estetikisht!



LIRIZMI I ÇUDITSHËM

Krijimtaria poetike e Moikom Zeqos është një dukuri krejt e veçantë në poezinë tonë. Stili i tij ka sjellë një mënyrë dhe koncept krejt të ri në pasqyrimin e realitetit objektiv dhe atij subjektiv mbi botën dhe njeriun. Ka sjellë krijimin e një figuracioni të veçantë artistik, një ligjërim suigeneris dhe një stil konceptual avangardist të panjohur më parë.

Moikom Zeqo është nga krijuesit tanë më eruditë që ka ditur të përvetësojë nga teknika krijuese e poezisë botërore më të avancuar. Ai, jo vetëm e ka pohuar, por edhe e ka realizuar, në mënyrën e vet përvojën e poezisë antike të Pindarit dhe atë të futurizmit të fillimit të shekullit të njëzetë dhe, konkretisht, figuracionin kozmogonik të Majakovskit.

Ashtu siç pohohet, çdo talent i shquar duhet, jo vetëm të mësojë, por edhe të synojë personalizimin e vet individual, në raport me traditën. Çdo poet i vërtetë duhet të synojë t'i kapërcejë mësuesit e vet,

të krijojë stilin e vet. Në këtë rrugë ka ditur të ecë me këmbëngulje dhe pasion Moikom Zeqo.

Moikom Zeqo ka arritur të krijojë strofën e tij të veçantë dhe të papërsëritshme, jo vetë grafikisht, por edhe emocionalisht. Ajo, mbi të gjitha, është lakonike dhe me një densitet të jashtzakonshëm të mendimit dhe të figuracionit.

Një karakteristikë e saj është ndërtimi shumëstresor i saj. Strofa e Moikomit i ngjan gypit të kaleidoskopit, i cili përziën copra shumëngjyrëshe të qelqta dhe krijon figura të çuditshme. Moikomi rendit në strofën e vet vargje “ngjyra-ngjyra si në poezinë “Balsamosmëni si kometë”, që po e marr vetëm si një shembull.

“Me vështrim i ngre edhe pemët në qiell!

Po ju s’e dini, s’e dini!

Ky burim i bjeshkës lëviz pjerrëtas si dhëpër e tejdukshme!

Këtu hijen time s’ma prangon as Hëna!

Shoh dy gjethe përdhe: këmbët e zbathura të feminisë!

Por ah, s’ecin më!

S’lëvizin dot!

Për pasardhësit më balsamosni, ju lutem, si kometë në ajër!

I parë veças secili varg ose dyvargësh nuk funksionon, duket i shkëputur dhe pa lidhje me

togvargëshet e tjera. Autori nuk preokupohet për t'i lidhur ato me lidhëse renditëse apo nënrenditëse shkakore, mohuese apo pohuese, me parafjalë të ndryshme. Poeti e fillon poezinë me një varg abstragues, për të kaluar në një pyetje retorike; papritur na del një peizazh i personalizuar me dhelprën; pastaj hija e heroit lirik që lundron tok me përroin; befasuese është metonimia, që i kujton fëmininë dhe si epilog i një jete njerëzore të projektuar në sfondin kozmik në mënyrë simbolike me një kometë, që vulos idenë e përjetësisë metafizike të jetës njerëzore.

Kjo na flet për një logjikë krijuese spontane dhe surprizuese, e cila nuk respekton aspak, jo vetëm rregullin e prozodisë metrike, por as atë të vargut të lirë.

Në ditët tona problemi i mungesës së ndërgjegjshmërisë krijuese shikohet si një proces kompleks filozofik, psikologjik dhe fiziologjik. Kjo teori e pranon se krijimtaria artistike shfaqet si kërkesë e vazhdueshme për një krijimtari të re e cila ndjek edhe një rend të ri krijues, që mund të duket si mungesë e ndërgjegjshmërisë krijuese. Ky bashkim “coprash” të shkëputura, të cilat çuditërisht na formojnë rrjedhën e një frymëzimi lirik ku merr pjesë meditimi abstrakt, përfytyrimi,

meditimi dhe kujtesa, pra, psiqika. Si rezultat kemi një procesi, jo vetëm artistik, por edhe estetik. Poezia na emocionon dhe na le një shije të veçantë estetike.

Në qoftë se do ta shikonim edhe si një proces të rregullt fiziologjik të vetë përshkallëzimit të perceptimit, nuk do të gabonim shkencërisht.

Teoria e kuanteve na pohon se grimca është një pjesë e valës dhe, në të njëjtën kohë, ajo ka edhe vetitë e vetë valës, ajo vepron edhe si grimcë edhe si valë njëkohësisht.

Akademiku L. Llandam e shtyn më tej gjykimin tonë.

Ai shkruan: "Njeriu në procesin e njohjes së natyrës mund të shkëputet nga përfytyrimet e veta, ai mund të zbulojë dhe të përvoetësojë, bile, ato të cilat janë jashtë mundësive të tij për t'i paraqitur".

Kjo është një qasje krejt të re ndaj ligjërimit poetik, një qasje moderne e cila e motivon më tej vizionin poetik dhe i jep të drejtë poetit të abstragojë përtej kufijve të ndërjegjes së zakonshme, duke prekur edhe vetë kufijtë e nënndërgjegjes .

Moikom Zeqo me vizionin e tij krijues avangardist arrin në kufijtë e një ligjërimit poetik të jashtëzakonshëm.

EROSI NË POEZI

Kjo temë është e lashtë sa jeta në poezinë gojore dhe në atë të shkruar, një temë e përjetshme. Moikomi na e bën të qartë se do të na flasë, jo me gjuhën e rëndomtë, “me një gjuhë prej dheu”, por me gjuhën me gjuhën e figurshme dhe simbolike ku tokësorja gërshetohet me hyjnoren, intima me shoqëroren.

Poeti e koncepton Dashurinë metaforikisht si “amforë të zotave”, një “vegjë” ku “nga njëra anë je ti (e dashur) dhe “nga ana tjetër “jam unë (i dashuri), që e mbajnë këtë dhuratë hyjnore”. Për poetin Dashuria është një festë genuine e njeriut që gëzon shpirtin e tij. Idhulli magjik i kësaj feste është trupi i dashuruar. Ai është tempulli ku festohet kjo kremte e madhe e jetës njerëzore (“Festë e shpirtit tim/Në trupin tënd magjik”).

Me gjithë shenjtërinë e saj hyjnore, ajo, njëheresh, është edhe një dashuri “mëkatore”. Ndëgjegjja nuk nuk i bën dot ballë dashurisë që e magjeps me “ndriçimin e mishit” (“...emocionet/

Janë ndriçim i mishit”). “Mëkati” është pasioni mishëror, që e shoqëron dashurinë tokësore:

*“Të dy, e dashur,
Kemi seks prej shtrëngate”*

Moikomi i këndon një dashurie reale e cila e përjetuar fizikisht dhe shpirtisht është aq e fuqishme, sa edhe vdekja nuk është gjë përpara pushtetit të saj:

*“I pavdekur nga vdekja
Por krejt i vdekshëm nga Dashuria”.*

Sigurisht, ky është një artifis artistik, që nuk ka të bëjë me konceptin idealist apo romantik të poetit. Artifis i cili i kundërvihet një realiteti malinj, që e sfidon intimitetin e ndjenjës së dashurisë, “shenjtërinë” humane, larine e saj genuine.

Heroi lirik i Moikomit jeton në një shoqëri aspak të lirë nga konceptet e saj pardoksale. Mjedisi shoqëror konservator përpiqet ta tjetërsojë individin, i “vesh rrobën priftërore”, nuk e lejon të jetë i lirë në mentalitetet e veta. Në një shoqëri të tillë kur Dashuria bëhet shpesh viktimë e intrigave dhe bestytnive, asaj i duhet të verë “parzmore”.

Njëkohësisht, nga ana tjetër, Moikomi në krijimtarinë e tij poetike i mban larg çastet e përditshërisë njerëzore. Për të, çasti konkret mund të fshihet shpejt nga kujtesa e përditshme . Të pavdekshme mbeten çastet e sublimuara artistikisht nga letërsia. Ai e njeh dhe e vlerëson, mbi të gjitha, forcën dhe magjinë e figurave artistike. Për të mbetet frymëzim Shekspiri, të cilin kritikë Harol Blum, e quan shkrimtarin që e ribëri Njerinë. Poeti na sjell në kujtesë figurën tragjike të Ofelisë:

*“Vetëm e Pamundura
Mban në duar
Vellon nusërore të Ofelisë
Të pamartuar në altar”*

Këto “barbari të çuditshme”, janë fantazmë hakërruese edhe në ditë tona.

Poeti shtron natyrshëm edhe dilemën frojdiane nëpërmjet një pyetjeje retorike, që nuk ka nevojë për përgjigje. Poezia e vërtetë, na i hedh tërthori pyetjet e saj dhe përgjijen duhet ta gjejnë vetë. Në këtë “heshtje”, në këtë të pathënë, qëndron dhe forca sugjestonuese e strofës së Moikomit:

“Kush e ka tani

*fjalën e fundit?
Libidja?
Apo Thanatosi”?*

Përgjigjen e figurshme të iluminuar na e jep me dy togvargjet e mëposhtme nga dy strofa të ndryshme:

*“Në anën tjetër të Vdekjes
Është sërish Dashuria”*

.....

*“Brenda meje ka shtigje
ku ti ecën e vetme Dashuri”*

Kredon e tij mbi përjetësinë e Dashurisë, frymëzimmin e pavdekshëm të saj, Poeti na e jep në vargun:


“...në Kohën Dashuri – ka vetëm ne të dy, së bashku në jetë, - së bashku në vdekje”.

Përjetësinë e dashurisë e përcakton jetëgjatësia e sa sublime.j

Ky është Portreti human dhe tragjik, por i pamposhtur i dashurisë mikomiane! Në të kemi edhe bashëkohësi edhe mitologji, ngazëllim dehës

dhe trishtim, lirizëm dhe tragjizëm, realizëm dhe misticizëm. Kemi parabola mitologjike dhe ilustrime letrare nga letërsia botërore. Mbi të gjitha, kemi një sublimim të Dashurisë.

Shpirti dhe ligjërimi poetik moikomjan janë në sinkroni. Mbi të gjitha, është ndershmëria e ndjenjës dhe e moralit të poetit, që e bën krijimin e tij të vërtetë dhe mbresëlënës.



MITOLOGEMA E JETËS, E VDEKJES DHE E PËRJETËSISË

Duke shfletuar vëllimet poetike të Moikom Zeqos, më duket sikur po shkel kozmosin e tij poetik, ku çdo libër mban emrin e një “planeti”. Në secilin “planet” gjej Jetën, Vdekjen dhe Përjetësinë pranë e pranë njëra-tjetrës si “një simetri metafizike në ekranin e imagjinatës” së poetit.

Moikom Zeqo në hyrje të kozmogonisë së tij poetike vë vargjet e poetit Yeatis, si një mbishkrim dantesk:

*“Kalorës,
Hidhi një sy Jetës dhe Vdekjes
Pastaj ec dhe vrapo”.*

Ky vrap është “një endacakëri e cila mbaron pa arritur “Qytetin e ëndrrës”, amëshimin, shkruan poeti.

Moikomi sheston mentalitetin e njeriut të lashtë, që e pranonte qetësisht ardhjen e vdekjes si një diçka të natyrshme:

*“E urrejmë Vdekjen
Por jemi që të gjithë të saj të”.*

Poeti e barazon strukturën konceptuale midis Jetës dhe Vdekjes. E pranon këtë alternativë enigmatike absurde:

*“Jeta është te Vdekja
(Kur Jeta ndihmon Vdekjen)
Vdekja është te Jeta
(Kur Vdekja ndihmon Jetën)”*

Poeti i mëshon përvojës jetësore të përditshme, e cila i jep një kuptim jetës mbi tokë dhe motivit për ta jetuar maksimalisht, pavarësisht se jeta ka një fillim dhe një mbarim:

*“Kur s’ke mësuar si të jetosh,
Si ta mësosh vdekjen?”.*

Ta pranosh vdekjen, do të thotë që ta sfidosh idenë e mosekzistencës fizike të saj e cila “në

ekranin e imagjinatës/ duket dhe zhduket”.

Për poetin tri janë faktorët për të shmangur “magjinë tragjike” sugjestionuese e të pashmangshme të Vdekjes: Besimi shpirtëror. Dituria. Poezia.

Struktura konceptuale e poetit mbi Vdekjen bie ndesh me filozofinë fetare:

*“Jeta është një endacakëri
Mes tempujve të braktisur
Dhe simboleve të rinj
Që na dëshpërojnë në pavetëdijën
Pafundimisht”.*

Ai dyshon dhe në strukturën konceptuale të Diturisë:

*“Dija
më shfrytëzon vetëdijën,
Mos vallë e mbulon
Vdekjen kjo shami?”*

Poeti i drejton sytë nga Krijimtaria Letrare.

*Vdekja – rri e bruzdë mbi mua – si parabolë
kozmiqe – e sekreteve – që duhej t’jua thoja – dhe s’ua
thashë kurrë!*

*Le të flasë Fjala dhe pa mua**(Psalmi 151)*

E vetmja “armë” i mbetet struktura konceptuale që ai ka mbi fuqinë e fjalës artistike. Ai mëton ta “galvanizojë” Vdekjen me “mitet dhe fjalët e tij”. I jep Poetit rolin e një magjistari që “ e magjeps vdekjen, nga shtrigë/në sirenë e kthen”. I etur për Jetën ai pranon të bëhet “Kalorës i pamposhtur”, don Kishot i “ëndrrës për jetën”.

Ai e sfidon vdekjen me sticizmin e tij spartan ndaj çdo paralajmërimi ogurzi, që i bën ajo me lajmëtarë ogurzinj e të pabesë në jetën e përditshme njerëzore

*“Do ta zgjas kohën
E udhëtimit tim,
Si çamçakiz,
Në gojën e një King Kongu!”*

Ai ka besim, jo vetëm në karakterin e tij spartan, por, mbi të gjitha, në “armët” e mjeshtërisë së tij krijuese, në energjinë e frymëzimit të genuine, që i fabrikon këto armë të lashta të poezisë dhe, mbi të gjitha, në metaforat e tij konceptuale unike, të

cilat kanë energjinë, fuqinë dhe magjinë potenciale estetike të pavdekshme:

*“Le të ngrihet
Vetë Vdekja t’i pagëzojë
Kundërshtarët e saj –
Metaforat e mia!”*

Poetin e mundon metamorfoza “jetë, vdekje, përjetësi” si një “parabolë kozmike” sekretet e së cilës nuk i ka kumtuar dot askush. Stafetën e saj mistike, ai ia le Fjalës: *“Le të flasë Fjala dhe pa mua”*. Këtë sfidë poeti e bnt në emër të Jetës: *“Vdeksha vetëm për përsosjen tënde!”*, shkruan ai.

Vdekja për poetin shikohet si kalimi në një jetë të re.

*“Qetësia
E pasvdekjes vjen,
Më përqafton*

*Valkire e verbër
Dhe e pagojë!”*

Për të Mbijetesa është një mit!
Vdekja gjykohet si kalimi në një Jetë të Re.

Moikom Zeqo krijon filozofinë e vet të jetës në përputhje me filozofinë kozmogonike:

*“I mbështjellë
Me nebulozat
E Pasdekjes
Do të vazhdoj
Të jetoj”.*

*“I gjej punë, patjetër, vetvetes,
Edhe i vdekur”
“mund t’u jap lajme
Të gjallëve kuriozë, që nga vdekja memece.”*


Për poetin “Amëshimi është Kozmosi, i vetëmjaftueshëm”. Përjetësia – reflekton – po aq Fundin, - sa dhe Fillimin e një “jete” të re. Kjo jetë e re ka strukturën konceptuale të Panteizmit: “Panteizmi shpirtëror është mjeshtëria ime”. Poeti e le Fantazinë dhe Frymëzimin e tij në kujdestarinë e yjeve: “Le të flasë Fjala për mua”.

Krijimtaria poetike e Moikom Zeqos është një mitologemë e paparë në letërsinë tonë mbi Jetën, Vdekjen dhe Pavdekësinë e trajtuar kryesisht në planin filozofik, ku në qendër është Njeriu me universin dhe psikologjinë e vet bashkëkohore.

Poeti, Eruditi, Filozofi, pse jo dhe Dijetari jeton në epokën e shndërimeve të mëdha në çdo fushë të jetës lëndore dhe metafizike, në kohën e relativiteteve të reja, kur zbulimet shkencore dhe shpejtësia e fluturimeve kozmike po shndërrohen në një metaforë të jetëgjatësisë njerëzore.

Në planin artistik ky është një konceptim i ri i mbarështrimit të lëndës letrare, të derdhjes së re të saj në forma të reja moderne dhe postmoderne. Ndërsa në planin estetik po zgjerohen kufijtë dhe nocionet kozmike të estetikës.

Moikom Zeqo është në avangardë të artit tonë kombëtar edhe të konceptin crucial të Trinisë universale Jeta- Vdekja- Pavdekësia.



SINKRETIZMI KONCEPTUAL

Moikom Zeqo në parathëmien e librit “Përjetësi me Qira” shkruan: *“Në poezitë e mia kreshpërohen shumë imazhe vullkanike që mund t’i quaj si digjitale. Fjalët janë shpesh të organizuara sipas një algoritmi të fshehtë dhe tepër genuin për mua dhe përvojat psikike të mendimit krijues, për një carmen perpetum”*.

Ç’është ky “algoritëm i fshehtë”?

Algoritmi, sipas konceptit euklidian, nënkupton zgjidhjen hap pas hapi të një problemi. Në këtë rast, ku bëhet fjalë për krijimtarinë poetike, si pasqyrim i botës, termi “algoritmi i fshehtë” nënkupton klasifikimin e formave bazë, që përbëjnë radhën e pasqyrimit artistik të realitetit.

Sipas mendimit teorik bashkëkohor nën ecurinë e procesit të pasqyrimit,, strukturimi i formave bazë, sistemimit, modelit e pasqyrimit të realitetit dhe botëkuptimit të autorit mbi botën. vendimtar në këtë proces është stili gjenuin i autorit dhe “përvoja psikike e mendimit krijues” të vetë poetit.

Këtë e pasqyron më së miri njësia më e preferuar

e organizimit të frymëzimit poetik të Moikomiti, Strofa dhe sendërtimi i saj grafik dhe sintaktik. Strofa e poetit i ngjan një kaleidoskopi magjik. Ajo është një strofë sinkretike.

Moikomi është i ndërgjegjshëm artistikisht dhe filozofikisht se dukuritë e ndryshme të jetës s'janë gjë tjetër veç se pjesëza të një të tëre, që përbën mozaikun e koncepteve të tij mbi jetën fizike dhe atë metafizike, që përfshin hapësirën dhe kohën e ndjenjave, të mendimeve dhe të veprimeve që konturojnë botën reale dhe atë shpirtërore.

Ky vizion i Moikom Zeqos i bën jehonë paradigmës bashkëkohore, të qojtur “ekologjike”.

Kjo paradigmë, në vend të principit të sistemit mekanik të diturive, mbështet principin e korelacionit. Ky koncept nuk e ndan objektin nga subjekti. Ai pranon idenë e tërësisë estetike të botës, duke iu kundërvënë teorisë të copëtimit të saj.

Sipas studjuesve të ndryshëm të ditëve tona, ky proces është ripërtëritja në kushtet e sotme e sinkretizmit antik në planin konceptual, mendor dhe jo,thjesht, të gjinive të ndryshme të artit. Kjo traditë e ka fillësën që me Rilindjen Evropiane të shekullit XIV.

Po sjell një citat të J. Llotmanit për Danten, si argumrnt të këtij sinkretizmi, të cilën e bënë të tyren

korifejtë e mëvonshëm të poezisë botërore: *“Integrimi ishte i natyrshëm për idealin e tij: enciklopedizmi i njohurive, që përfshinte të gjithë arsenalin e shkencës të kohës së tij, nuk u perceptua në ndërgjegjen e tij si shuma e ndarë e njohurive, ai ndërtoi një ndërtesë të vetme të integruar”*.

Këtë traditë e ka bërë të tijën edhe poeti ynë avangardist Moikom Zeqo.

Në ligjërimin e tij strofik poetik pleksen me njëra me tjetrën koncepte të ndryshme mbi jetën, mbi vdekjen, mbi dashurinë, përjetësinë, natyrën dhe mbi hapësirën kozmike.

Duke lexuar vëllimet e tij poetike, u binda plotësisht për vizionin e tij gjithëpërfshirës artistik dhe estetik sinkretik shumëplanësh.

Vargjet e strofës së Moikomit nuk lidhen sipas logjikës së zakonshme bashkërenditëse, ku një varg ia përcjell vargut tjetër mendimin e vet duke e thelluar më tej hap pas hapi atë.

Sendërtimi logjik dhe lidhja midis tyre është e beftë.

Moikomi ligjëron me shtresa të ndryshme kulturore ose me mentalitete të ndryshme, duke gërshetuar epokat, ose duke i vënë përballë njëra-tjetrës, duke hequr paralele ose duke vënë përballë antiteza.

Nuk është e mundur që gramatika, morfologjia t'i lidhë këto shtresa. Është sintaksa që lidh fjalët në togfjalësha ose në fjali dhe vetë fjalitë midis tyre. Është sintaksa e strofës konceptuale që lidh nocionet shkak-pasojë, logjikën e përgjithshme të strofës.

Edhe në fjalorin poetik gjejmë fqinjësi fjalësh, jo vetëm nga sfera të ndryshme, por edhe nga epoka të ndryshme të cilat sinkretizojnë semiotika dhe botëkuptime të largëta. Fjalori, fjalitë, sistemi figurativ, metaforat bashkërenditen dhe lidhen në bazë të parimeve të teorisë së relativitetit dhe të mekanikës kuantike. Por jo vetëm këto.


Lexoni me vemendje krijimtarinë poetike të Moikomit.

Me shumë vështirësi do të mund të gjeni poezi monotematike! Në ligjërimin e tij strofik poetik pleksen me njëra me tjetrën koncepte të ndryshme mbi jetën, mbi vdekjen, dashurinë, përjetësinë, natyrën dhe hapësirën kozmike, me gjithçka konkrete dhe abstrakte, që trajton ai në poezitë e tij.

Për të evidentuar dhe studjuar konceptet e ndryshme të tij mbi jetën, dashurinë, vdekjen dhe pavdekësinë, m'u desh t'i tëharrja me kujdes dhe me durim të madh vargjet që flisnin për to. Dhe pyetja se bëra mirë apo jo që i shkëputa nga konteksti i

strofës, më mundoj vazhdimisht. Një gjë më shtyri ta vazhdoj këtë punë. Mendimi se eseja nuk është krijimtari e mirëfilltë. Ajo anon nga përndritja. Nga studimi. Nga analiza konkrete. Dhe çdo analizë nuk mund të bëhet pa “autopsinë” e veprës letrare.

Kjo punë më bindi përfundimisht dhe plotësisht, se krijimtaria poetike e Moikom Zeqos është modeli i plotë dhe i përsosur i sinkretizmit artistik. Dhe se shprehjet e tij: *“alogaritmi i fshehtë dhe tepër genuin”* dhe *“përvojat psikike të mendimit krijues, për një carmen perpetuum”* janë shprehja gjuine e kësaj kredoje së tij krijuese, të sinkretizmit të tij të pashëmbëllt në poezinë dhe letërsinë tonë kombëtare, dëshmi të gjenialitetit të tij avangardist.



UNIVERSALITETI I POEZISË

Poetin Moikom Zeqo e ka yshtur që herët idea e zgjerimit të kufijve tematikë të pasqyrimit të realitetit, duke gërshetuar tokësoren me kozmiken. Diku ai ka shkruar se arti është martesë me kozmiken. Në librin “Centauri i Fundit” ai shkruan: “Duke qenë një autor shqiptar, më nxiste idea jo shumë e qartë ose e organizuar se kisha të drejtë për të shkruar për subjekte universale”.

Tematika universale është e lashtë në krijimtarinë botërore. Kjo tematikë ka pasqyruar lidhjen e njeriut me Gjithësinë nëpërmjet të mitologemave të ndryshme. Njeriu ka dhuntinë e çuditshme për të zbuluar dhe për ta njohur çdo gjë që ekziston në botën të cilën e heton me shqisat e veta, duke përfshirë dhe Gjithësinë.

Ëndrrën e tij të guximshme krijuese të universalizimit të tematikës, Moikomi e lidh, në radhë të parë, me konceptin mbi Kohën dhe veçanërisht me raportin e konceptit mbi të qenin dhe atij të ndryshimit.

Moikomi shkruan në “Centauri i Fundit” se në Mesjetë ekzistonte një koncept ndryshe mbi Kohën, e cila perceptohej e deformuar si kohë e përkohshme e vuajtjes dhe e mëkatit....Ndjenja e të ekzistuarit ishte ndjenja e të qenit dhe ndjenja e të qenit nuk ishte ndjenja e të ndryshuarit.

Poetin tonë e shqetëson pyetja e “rindërtimit të koncepteve mbi Kohën dhe të ndërkohëve”. Për Moikomin “agimet vijnë të ndryshme përherë si të zgjedhuarit të foljeve”. Ai ka parasysh ndryshimin e vazhdueshëm dhe të përhershëm, domethënë, të gjitha kohët: të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen.

Poezia e Moikom Zeqos është një “palimpsest|” i gjithëkohësisë. Ëndrra të ndryshme realiste dhe surrealistike kanë zëvendësuar njëra-tjetrën historikisht. Moikomi e pohon edhe vetë se atë e ka shqetësuar misteri i etheve të amshimit.

“Fjalët vijnë,- shkruan ai,- veçse nga fundi i një Realiteti, që është Pafundësia”.

Ai jeton në një hapësirë dhe kohë kur ka filluar rënia e zotave. Ai shkruan për këtë kohë fatale për shekullin, që mban në duar “kyçin e ndërtimit të Vetmisë sonë universale”. Panteizmi i tij kozmik i bën jehonë sugjestionit të çuditshëm të vetë Ajnshtajnit mbi inteligjencën e fshehtë dhe të

pakomandueshme të lëvizjeve të universit. Për një cast atë e pushton mëshira për njerëzimin:

*“Shtrydh hojet
E Arushës së Madhe,
Ç’mjaltë dashurie
Për ju, për ju!”*

Por nuk qenka një zgjidhje kaq e lehtë:
“Tek honi i kohës Përplasem me përbindshat”
shkruan ai. Përbindshi më i madh është vetë Njeriu:

*“Qenia njerëzore!
S’është
Algjebrisht e përcaktuar:
Kaq përqindje politikë,
Kaq dinjitet, frikë, sharje,
Kaq kulturë, seks,
Ligësi, dyshime,
Kaq kujtesë
Dhe po kaq Harresë”*

Misioni i poetit është rinovimi i konceptit mbi kohën dhe mbi njeriun: “Duhet njëqind herë Ferrin i gjallë ta kalosh, që më në fund të vdesësh në paqe si njeri”.

Në këtë kohë pakohë jeton dhe lëviz Njeriu me pyetjen e tij ekzistenciale: “Ku po shkoj kështu me agimet si çelësa në xhepat e mi?”.

Njeriu, është një pjesë e vogël e Gjithësisë. Është një qenie komplekse me psikikë dhe moral kaq të komplikuar. me një koleksion të trashëguar dhe të “pasuruar” nga njëra kohë në kohën tjetër të pafundme, kur njeriu nuk është më “njeri” :

*“Ç’është kjo kohë
ku as Vdekja
as Jeta
s’janë pyetje
Dhe as përgjigje?”*

.....

“Pse kemi rënë në pluhurin dhe baltën e yjeve banalë?”

Poeti, siç e ka parim krijues, nuk merret me përditshmërinë dhe me konceptet “banale” të jetës, as me konceptet e vjetëruara për të. Ai nuk shkruan dot për çastet efemere. Përmasat kozmike të poezisë së Moikom Zeqos janë metafora e gjithëpërfshirjes të universit shpirtëror fizik dhe metafizik njerëzor. Synimi i tij është universalizimi i problematikës individuale dhe asaj shoqërore aktuale dhe të asaj gjithëkohore për jetën, për vdekjen dhe përjetësinë.

Nga ana tjetër, ai është i ndërgjegjshëm se trashëgon tradita të lashta kulturore, shpirtërore, historike letrare dhe estetike të patjetërsueshme, që janë shprehja e identitetit të patjetërsueshëm të njeriut.

“Tek xhepi i jelekut

Si orë të vjetër

E mbaj

Fytyrën

E Batos ilir”.

“Me praninë e De Radës jemi më të mirë se vetja”.

Në librin “Centauri i Fundit” Moikom na sjell mendimin e themeluesit të albanogjisë, Norbert Johlit, se njëtrajshmëria e formave të të menduarit, që njësohet nëpërmjet gjuhës, në radhë të parë të atyreve, që e flasin atë, përbën njëkohësisht dhe bazën themelore të ndërgjegjes kombëtare.

“Nga kafka s’më del dot, s’më del dot Shqipëria Mendore!”.

Këtë mision të universalizimit të poezisë ai e ka qojtur më tepër “një pamundësi utopike se sa një gjë të realizueshme lehtësisht”.

Kjo ngërthen në vetvete edhe një problem

delikat, i cilli lidhet, në mënyrë të ndërgjegjshme apo latente me ndrojtjen se universalja mos e fshin kombëtaren në krijimtarinë letrare.

Ky është vërtet një koncept që jeton në mendjen e çdo krijuesi. Koncepti i universales është, gjithashtu, një koncept që mbijeton në sferën mendore, por, në të njëjtën kohë, ai është një postulat i krijimtarisë artistike. Çdo krijim letrar nuk mund të jetë krijim i vërtetë, në qoftë se nuk është universal.


Është i njohur koncepti i Gëtes mbi “letërsinë botërore” (die Weltliteratur), që në thelp ka mendimin se artisti duhet ta zotërojë botën dhe të gjejë pasqyrimin adekuat artistik të saj.

Moikom Zeqo ka qenë i ndërgjegjshëm se për ta realizuar këtë ide sfiduese, që për realitetin shqiptar të asaj kohe të socializmit dhe të dominimit të metodës së realizmit socialit ishte më tepër “një pamundësi utopike se sa një gjë e realizueshme lehtësisht”.

Ky ishte një koncept krejt i ri dhe sfidues për kohën, gjë e cila kërkonte jo vetëm guxim, por edhe vizion të ri, që nënkupton edhe zgjerimin e kufijve të ngushta narrative të krijimtarisë nacionale..

Poeti Moikom Zeqo me korpusin e krijimtarisë së vet poetike, në mënyrë të ndërgjegjshme

dhe me një frymëzim të jashtëzakonshëm e ka nxjerrë tashmë poezinë tonë në rrugën e madhe të përgjithësimit artistik dhe të shijes universale estetike.



DY FJALË MBI MITOLOGJINË

Në krijimtarinë poetike të Moikom Zeqos ka lënë ndikimin e vet të padiskutueshëm, jo vetëm si prezencë konkrete e miteve të lashta me subjektet, personazhet, tematikën dhe mesazhet e saj, por nga anatjetër dhe me anën e panjohur, me konceptet iracinale.

Poezia, në vetvete, si proces artistik dhe estetik është njëraport midis racionales dhe emocionales, midis realitetit dhe ëndrrës.

Vetë misioni i saj i lidhjes së ndërveprimin midis Kohëve universale dhe kohësore tokë, është burim frymëzimi dhe arsenal për rikrijimin artistik të tablosë së jetës, atë të cilën miti nuk e pretendon.

Vetë miti është mishërim i enigmës së asaj që ka ndodhur dhe asaj që pritet të ndodhë.

Në një nga poezitë e tij Moikomi shkruan: *“Me një mulli kafeje bluaj sëprapthi Mitet”*.

Të bluash apo të ribluash, do të thotë të përfutosh një produkt të nevojshëm për përdorim konsumi

të përditshëm. Për Moikomin, metaforikisht, rikrijimin e kozmogonisë së tij poetike.

Në krijimtarinë poetike të poetit janë gërshetuar midis tyre, në një harmoni dhe unitet estetik, temat ekzistenciale të jetës tokësore.

Në të janë të pranishme mite kozmike, ekstatologjike dhe astrale.

Për Moikomin miti nuk është botëkuptim, por botëndijim.

Ai e pranon hapur hamendësimin e tij të çuditshëm: “Si ta shpik një mitologji të re? “.

Mitologjia ka dy aspekte, racionalen dhe iracionalen.

Racionalja e mitit lidhet me atë që njeriu i sotëm përpiqet ta zbardhë tablonë e botës sonë moderne.

Iracionalja lidhet me atë e cila ende nuk vërtetohet dhe nuk përputhet me dëshirën reale.

Pra, ne trashëgojmë ende diçka nga koncepti i lashtë mitologjik.

Edhe në ditët tona mitet e vjetra vazhdojnë të kenë një farë peshe, sepse vazhdon të ekzistojë raporti midis racinales dhe iracionales.. Ekziston ende dyshimi dhe shpresa jonë për një të ardhme më të mirë.

Ky është tashmë një koncept i pranuar sot botërisht nga studjuesit e ndryshëm.

Bëhet fjalë, pra, për një “mitologji të re”.

Në krijimtarinë e Moikomit ndodh “rimagnetizimi i mitologjisë”.

Këtë e realizon në dy mënyra.

Nga njëra anë heronjtë mitologjikë vijnë të shfaqen dhe të veprojnë në poezinë e Moikomit: *“Prometeu, si Monstër Mëkati, arrin tek Mbinjeriun Shpirtëror”* dhe *“Zarathustra me vullnetin e tij i bind kohërat dhe shekujt si të ishin kafshë të zbutura befas”*.

Ai u jep atributet mitologjike edhe figurave historike ose personazheve letrare:

*“ulërijnë virgjëreshat magjistare të Ilirisë!
Dhe kuajt pësojnë infarkte yjesh!*

Mbi detin Adriatik shoh si ngrihet mali Tomor
si një Sion i Dytë,

*“Statuja e Skënderbeut me kalë,
Shëtit në Shans-Elizé,
Në Ishullin e Pashkëve,
Madje dhe në Atlantidë”*

*Unë e ringjall Ofelinë e mbytur
Dhe e le të rrojë aq,
Sa për të vajtuar
Vdekjen e mëpasshme të Hamletit”*

Parimi i mitologjizimit është pjesë përbërëse e kozmogonisë poetike moikomiane.

Moikomi mitologjizon edhe tema të nxehta të realitetit modern, siç është edhe shoqëria jonë me probleme iracinale, që pengojnë prosperitetin shoqëror:

“Realja, - kërkon – ta shfaqë përherë – pamjen tjetër – të saj, - në një Univers të Ri, - të mrekullueshëm, - a të tmerrshëm!”

*“Qeni i Hadit
Me nofulla në re,
Kërcënon,
Të kafshojë kohërat”.*

“Urrejtja ringjall befas mite” Dhe ndoshta është i vetmi univers,

*“Midis Jetës
Dhe Vdekjes
Është Kumari!”*

*“Kohën e shoh
Si menynë
E një Party të Ferrit!”*

*“Në hapësirat e Globalizmit
Rrinë diku filozofët në harrim,*

*Si kukulla hekuri, të ndryshkura!!
Dhe truri i zotave del
Nga anusi i njerëzkafshëve!”*

Më interesante është “mitologjia e cila paradoksalisht krijon. Siç shkruan Moikomi, “një kozmogoni të miteve efemere”.

Secili prej nesh ka historinë e jetës së vet personale. Historinë e “krijimit” të vet si qenie njerëzore, që fillon që nga paralindja e shoqëruar me pikëpyetje, enigma, parashikime dhe me fund të paparashikueshëm. Këtë histori na e tregojnë prindërit tanë dhe sidomos, gjyshet dhe gjyshërit taë. Historiaa e mëtejshme e jonë i përket makinës së fatit apo të kohës, të cilën e drejtojmë dhe nuk e drejtojmë vetë. Në thelb, pra, një mit i vërtetë.

Kemi kujtimet e shtrenjta të jetës sonë, kemi jetën tonë ku është e pranishme realja dhe ëndrra, racionalja dhe iracionalja. Nohim jetën, por jo pasjetën, enigmën e vdekjes apo të amëshimit sipas bindjes sonë shpirtërore. Një mitologji e vërtetë efemere.

Moikomi shkruan për qytetin e tij të lindjes:

“Shtëpia ime e lindjes në Durrës – s’do të jetë spiranca e Imagjinatës, -për çdo rikthim, - por direku i velave – përherë të hapura -prej erërave!” Dhe më e shtrenjta: “përralla e Currilave” dhe “varka e vjetër – e nxjerrë në breg”. Dhe legjenda e “vajzës së mbretit ilir Epidamn, Melisës që dashuroi Hyu i Detit Redoni.

Dhe lindi djalin e mrekullueshëm Dyrrah!”.

Tërë korpusi i Kozmogonisë poetike të Moikomiti mua më ngjan me një simfoni shumëtemëshe që gërshetohen midis tyre, shfaqen dhe sfumohen sipas rastit dhe ridalin përsëri të zhvilluara më tej, një “simfoni” poetike, si Miti i Gjyshe Faikas, që e qëmtova në katër libra:

Një shtëpi të motshme, që “bie erë naftalinë”, në Jug ku në kopshtin e saj janë “rrënjët”, “prangat sakrale nën dhé”. Prangat e kujtimeve të Poetit.

Në këtë shtëpi jeton Gjyshe Faika.

Gjyshja Faika “tund kanatën, e hapur të dritares, si marinari flamurin e sinjaleve, mbi anije, për të komunikuar me gjithçka, në det, në qiell dhe në tokë!”.

“Tek këmbët e tua, - nënë, - ka rënë, - vetë Mona Liza, - në gjunjë – dhe lutet – plot adhurim!

Dhe Shën Maria, - të vetmen, - që ti e besojë, - kalon shpesh, tek ty, - vjen të të takojë, - pini – kafen e zezë, - me aromë rozmarine, - Shën Maria flet, - kurse ti hesht, - e mallëngjyer, - më në fund, - ajo të sheh me buzëqeshje – filxhanin, - por në Amëshim,

-s'ke më asnjë nevojë,-për të mësuar,-të Ardhmen!"

(Këmbësori Kozmik)

"Gjyshja ime Faika shkonte për ca kohë

Dhe kthehej nga bota e poshtme e përrallave.

(Këmbësori kozmik)

"Pi duhan me çibuk

Dhe bluan në mullirin e kafes

Shekujt e gjenealogjisë së fisit tim".

(Golgotë fluturash)

"Gjyshja Faika me bishtukun e yllit të Afërditës

Ëndërron në mugëtirë vajzërinë"

(Përjetësi me Qira)

"Kujtoj vitet e fundit – të gjyshes Faika, - u dobësua kaq shumë, - rrinte në shtrat – dhe protezën e dhëmbëve – e linte tek gota e ujit – dhe kjo protezë – më ngjante si Cerberi – në Ferrin e Gojës – së Vdekjes. Gjyshja vdiq në gjumë, - e humbi çastin ringjallës të zgjimit, - e

humbi kohën efemere të trandafilave – në oborr – dhe nga dritarja e hapur – mbi të u vërtitën –

flutura të çuditshme, - u përplasën tek fotografitë në mur – dhe kur dolën jashtë – u shndërruan në shqiponja – të fuqishme,- për t’u zhdukur – në qiej!”.

(Grifonët në Shishe)

Një mit bashkëkohor vërtet brilant!

DUKE PRITUR LEXUESIN E VËRTETË

Në librin “Gorgonët në shishe” Moikom Zeqo ka botuar njëmbëdhjetë poezi me titullin biblik Psalm.

Tematika e tyre është tematika e preferuar e poetit mbi jetën, vdekjen, amëshimin, duke lënë jashtë temat e përditshërisë efemer të jetës njerëzore. Sfondi konkret është i minimizuar, është i papërfillshëm ndaj hapësirës së pafund universale ku jehon ligjërimi poetik i autorit, një ligjërim liriko-epik me sharm meditativ- filozofik dhe ton të theksuar dramatik.

Në këtë cikël mbisundon vuajtja, pendesa, stoicizmi dhe lutja e dëshpëruar njerëzore ndaj destinit:

“Universi lëviz, rrjedh mes syve të Asgjësë”

(Psalmi 152),

“Ka shumë asgjë tek diçkaja dhe kaq pakohësi te Koha!”

(Psalmi 158)

“Ç’trajtë ka tani e Vërteta, mes kaq peizazheve të Iluzionit?”

(Psalmi 160),

“Tani jeta mund të jetë gjetiu, mund të jetë në anën tjetër të Vdekjes – dhe jo në anën tjetër të Dashurisë”

(Psalmi 159)

“Mes sendeve të pavdekshme pse isha (jam) kaq i vdekshëm!”

(Psalmi 153)

Kjo tematikë është trajtuar në forma apo aspekte të ndryshme nga njëra poezi te tjetra.

Në art rëndësi ka, mbi të gjitha, jo thjesht mënyra e trajtimit, por forma në të cilën është derdhur kjo përmbajtje. Stili i autorit.

Moikomi, për këtë materje shoqëro-filozofike, ka zgjedhur psalmin biblik.

Psalmi, në rastin konkret, përshkruan një gjendje të rëndë psikologjike të një heroi lirik ateist, me një botëkuptim panteist, do të thosha panuniversal. Ai nuk merr mbi vete rolin e Mesisë: “Ç’do druri në bregdet, që përkulet para meje, unë i them: “kalo, mik,...unë nuk jam Mesia!” (Psalmi 161). Ssakramenti i Shpëtimit” për të mbetet vetë

Poezia. Pra, figurshëm, për të është Muza, Fjala: "Letë flasë Fjala dhe pa mua" (Psalmi 151).

I lexoj dhe i rilexoj këto Psalme dhe çdo herë çuditem.

Çuditem me konstruktin e tyre. I çuditshëm është gërshetimi i pasazheve të tyre mendore dhe emocinale.

Ato janë shkruar me një gjuhë të pastër, të rregullt morfologjikisht dhe sintaktisht.

Mendimi i çdo kuanti vargjesh, i çdo mendimi është i qartë.

Të çudit fqinjësia e tyre. Vijimësia e tyre të shtang. Detyrohesh ta sforcosh gjykimin për të depërtuar në logjikën e tyre kontekstuale.

Logjika e leximit të poezisë së zakonshme, tradicionale nuk funksionon.

Kemi një poezi krejt ndryshe. Jo vetëm se nuk është një poezi metrike, me varg të matur, me rima dhe me theksa ritmikë të rregullt. Por nuk është as poezi e zakonshme me varg të lirë, të çliruar nga rregullat metrike, me një ritëm të vetin, që i mban në rresht dhe të lidhur midis tyre vargjet dhe tërë poezinë.

Vargu dhe poezia e tij është konceptuale. Atë e sendërton një logjikë tjetër.

Bëhet fjalër për dy koncepte krijuese. Për dy

mënyra të leximit të pozisë.

Po sjell një opinion të pranuar tashmë botërisht mbi shkrimtarin Xhejms Xhojs, që hapi një epokë të re në letërsinë botërore me të famshmin koncept “përroi i ndërgjegjes” si matricë të letërsisë moderne evropiane dhe asaj botërore.

Më poshtë është opinioni i autorit J. Halimin mbi veprën e Xhojsit:

“Po thuaj se të gjithë heronjtë e “Uliksit” (roman i Xhojsit) më duken qenie të gjalla shumëdimensionale, të cilat në vetvete bisedojnë me lexuesin dhe e çojnë atë në shtresa të panjohura të ndërgjegjes, prej së cilës është vështirë të dalësh”.

Shkrimtarja Mira Meksi, në një letër dërguar Moikom Zeqos i shkruan opinionin e saj për poezinë e ti, dhe, konkretisht, mbi Psalmët:

“Stili yt! Janë figura,- pse janë të pamundura nuk ekzistojnë as në realitetin jashtë ëndrrës, as të imagjinatës njerëzore,- por, kur i dëgjon në gjuhën e shenjtë aramaike, apo shqipe. Imagjinata vetë, prej magjepsjes, pjell një imagjinatë për t’i asimiluar dhe shijuar. Dhe atëherë ndjesitë njerëzore i kapërcejnë kufijtë që njohim dhe krijojnë ekstaza ndjesish, të ngjashme me ato të perëndive”.

Jetojmë në një epokë vërtet të çuditshme.

Po ndryshon matrica e krijimtarisë letrare.

Po ndryshon edhe matrica e gjykimit njerëzor.

Tezat më të reja të mekanikës kuantike dhe teoria e relativitetit na flasin për tru dhe ndërgjegje kuantike. Bile dhe për një psikologji kauntike.

Njeriu shikohet si kuant i sistemit universal. Mendimet dhe sjelljet e tij ndikojnë në shkallën më të madhe tek ai vetë dhe tek mjedisi që e rrethon.

Është e padiskutueshme që poeti Moikom Zeqo është i pari te ne, që po sjell këtë ndryshim, që letërsia botërore e ka filluar që një shkellu më parë. Është fjala për tematikën universale.

Kozmogonia poetike nuk është e re në poezinë tonë. Le të kujtojmë panteizmin naimjan apo “Vallen e yjve” të Lasgush Poradecit.

Moikomi shkon përtej trajtimit thjesht shpirtëror dhe mistik të kësaj teme.

Ai ka sjellë një hero lirik bashkëkohor, si një genie komplekse të ndërvarur. Mentaliteti i tij shtrihet përmes hapësirës dhe kohës. Ai e quan veten një pjesë të pandarë të universit, të lidhur me të po aq sa është i lidhur edhe me tokën.

Heroi i tij lirik e quan veten *“pasagjer pa emër të mrekullive që s’i di askush, në hapësirat, ku qytetet-etiketa janë në baulen e Kujtesës”*.

“O, takime të shkurtra me mrekullitë si pasqyrimet fluturake në pasqyra argjendi – pranë ëngjëjsh jashtë

vetes", deklaroi poeti.

Ai e ndjen këtë univers sikur të ishte një qenie e gjallë. E prek, e gëzon, e kupton, "erërat plot divnesa" e "rrethojnë si kore antike të Eskilit", ai "hingëllon "si një kalë nën pemën e Kozmosit" dhe "thellësirat tingëllojnë, tingëllojnë", "një shegë çan me shpërthime purpuri hapësirat e terreve demoniake".

Shqetësim për të është koha që "shket si hije zogjsh të pakapshëm", se "ka kaq shumë asgjë tek diçkaja dhe ka kaq pakohësi tek koha!", se "midis sendeve të pavdekshme" ndjehet "i vdekshëm".

Ai i ka shkruar në vitin 2009 njëri pas tjetrit të njëmbëdhjetë Psalmet si një divnesë dhe lutje, si një dëshmi të kohës sonë të çuditshme që po sjell ndryshime apokaliptike në çdo fushë të ekzistencës sonë. Na flet për "një kaleidoskop të shthurjes seksuale dhe të shkretëtirës mendore"

Është kjo gjuhë e figurshme, janë metafora dhe alegoritë fantastike Moikomiti që i bëjnë këto Psalme nga krijimet më të përsosura, "hyjnore" të poezisë mikomiane.

Përsa i përket vështirësisë së shijimit të sharmit të tyre estetik, po sjell një gjykim të Faik Konicës, që, me gjithë gjuhën e tij karakteristike thotë një të vërtetë të madhe:

"edhe eremiti që në vetminë e Tebaidës, i shkruan

afshet e veta mistike mbi blloqe stralli ose mbi rërë, që era pas pak ka për t'i marrë, ka para sysh një dorë lexuesish. Zotin, ëngjëjt, shenjtorët, djajtë. Prania e gjallë e kësaj kategorie mbinatyrore lexuesish të padukshëm i jep stilit të vetmitarëve me ngjyrë me një shije kaq të çuditshëm”.

Me gjithë tonin e tij karakteristik ironik, ka thënë të vërtetën e madhe se për t'i kuptuar shkrimtarët e mëdhenj të jashtëzakonshëm duhet një lexues po me kulturë aq të madhe për t'i lexuar dhe shijuar veprat e tyre.

Poezia e Moikom Zeqos është duke pritur këtë lexues të denjë!



“VLADIMIR MAJAKOVSKI, POEZI FUTURISTE”

Në librin “Vladimir Majakovski, Poezi Futuriste”, botim i Zenit Editions, 2018, Moikom Zeqo ka përmbledhur poezitë futuriste të poetit rus.

Njëzet vite më parë, kur i ka bërë këto përkthime, Moikomin e ka tërhequr më shumë zbulimi i sekretit të mjeshtërisë së figuracionit futurist të Majakovskit, gjuha e tij e figurshme metaforike dhe modeli i figuracionit universal hiperbolik, se sa synimi për të bërë një provë në fushën e përkthimit. I mundshëm është dhe synimi i dyfishtë i autorit.

Geni krijues i Moikomit e ka nuhatur këtë afërsi të natyrës së vet krijuese metaforike. Në këtë kuptim, këtë vëllim do ta quaja një provë të vyer të autorit për të përfituar nga përvoja e pararendësve të tij të mëdhenj në këtë fushë, sikurse edhe nga e gjeniut tjetër futurist, Hlebnikovi dhe më përpara akoma, nga përvoja e fluturimeve figurative të Pindarit të lashtë.

Poezia është gjinia letrare më e vështirë për t'u përkthyer, për t'u rikrijuar në një gjuhë tjetër. Vështirësia e parë lidhet me specifikën e gramatikës, me morfologjinë, sintaksën, semantikën, anën tingullore të gjuhës, sa e afërt apo sa e largët është gjuha e përkthimit me gjuhën e origjinalit dhe sa i njih dhe sa i zotëron këto përkthyesi. Për mendimin tim, një përkthim i arritur dhe sa më pak “tradhtar”, i kërkon të dyja. Vështirësia tjetër lidhet me stilin e autorit, me filozofinë e tij krijuese, me temperamentin, me preferencat e tij stilistike dhe estetike, me teknikën e prozodisë (vargu, metri, strofa, ritmi, rimat). Njohja e kohës historike, e stilit të rrymës apo të epokës, kur është krijuar origjinali, ka peshën e vet.

Shtyrsa fillestare dhe kryesore për Moikomin, do ketë qenë kërshëria, zbulimi i filozofisë krijuese futuriste, krijimtari e cila në Rusi u kthye në një rrymë që synonte një reformim të gjuhës dhe rolit të artit në këtë periudhë të trazuar historike të krizës së sistemit borgjez dhe të stuhisë së Luftës së parë Botërore.

Përkthyesi nuk është komentuesi, ai është, thjesht, një lexues inteligjent. Procesi i përkthimit është, mbi të gjitha, mjeshtëri. Si çdo mjeshtëri, ka në bazë përvetësimin e një teknike. Si në çdo zanat,

përvoja është kryesorja, zbulimi i sekreteve dhe teknikave të caktuara të një diçkaje të krijuar nga një mjeshtër.

Mjeshtërinë e përkthyesit unë do ta përqsasja me mjeshtërinë e aktorit, mjeshtërinë e këngëtarit, të instrumetistit, që interpreton një tekst, një karakter, një melodi, një partiturë. Pra, rikrijimin e një diçkaje të krijuar jo prej tij. Dhe kjo, patjetër, kërkon një prirje, një talent, që në thelb ka imitim. Moikomi ka ditur të operojë me kujdes në përkthimin e Majakovskit futurist.

Majakovski i jep rëndësi, jo vetëm brendisë dhe trajtimit të saj artistik dhe estetik, por edhe paraqitjes grafike të vargut, paraqitje e cila ka të bëjë me diagramën e mendimit dhe të emocionit poetik. Ai përdor edhe strofën katërshe, por edhe strofën monokollonë, sidomos në poemat, ku gjejmë dyvargëshin e rimuar në formë strofe jo strikte, të çrregullt.

Moikomi, duke shfrytëzuar natyrën stilistike të gjuhës sonë, ka operuar me guxim duke e ndryshuar këtë strukturë rreshtore, pa e cënuar vlerën artistike të vargëzimit. Dyvargëshin e ka kthyer në strofë, pa cënuar aspak brendinë dhe ritmin e vargut.

Në përkthimin e një poezie mund të preket vargu, metri, por kurrë ritmi dhe figuracioni. Dhe

Moikomi u qëndron besnik ritmit dhe figuracionit futurist të poezisë së poetit të madh novator rus.

Rima e Majakovskit është elementi i prozodisë më pak i nënshtrueshëm ndaj përkthimit. Moikomi është gjendur përpara një dileme të vështirë.

Rimat e Majakovskit janë rima disonante dhe të larmishme. Ato janë të jashtëzakonshme. Mund të rimojnë fjalët e fundit të dy vargjeve, fjala e fundit e një vargu me fjalën e parë të vargut tjetër, variante nga më të pabesueshmet dhe kryesisht, rima jo harmonike. Rimat novatore të poezisë futuriste të Majakovskit janë në përputhje me dinamikën e emocioneve të tij të jashtëzakonshme, me ritmin e vargut Ato përmbyllin si tamtamet e tamburit një marsh marcial. Këto rima nuk janë përputhje e zakonshme e zanoreve dhe e bashkëtingëlloreve, por përputhje disonante, asonanca zanoresh dhe bashkëtingëlloresh të çiftesh fjalësh.

Majakovski ndjek modelin e “çastushkave”, këngëve popullore ruse. Ja disa modele të kësaj rime (rusisht): “noski' poda'reni”/ “naski'peda'reni”;no'ç njikem/pozvono'çnji'ke; shago'v mnu/ Go'fmanu; u'lici u'zki/ kro'vi sgu'stki... Roli i tyre është tejet i rëndësishëm për vargun e Majakovskit. Ato janë të lidhura ngushtë me ritmin e vargut. Ai shkruan : “rima është fuçia me barut/ vargu fitili i saj/ vargu

tymon/ fuçia shpërthen/qyteti/fluturon në erë/
bashkë me strofën”.

Moikomi, gati, e ka mënjanuar këtë rimë. Ka bërë ndonjë përpjekje sporadike të zbehtë. Por ka hequr dorë. Është i mendimit se rima e Majakovskit është e papërkthyeshme. Poezia futuriste e Majakovskit i jep rimës një vlerë të veçantë' Në testamentin e tij poetik “Si shkruhen vargjet”, ai shkruan: “rima të kthen te vargu i mëparshëm, të detyron ta kujtosh atë, i detyron të gjitha vargjet, të formojnë një mendim, të qëndrojnë të bashkuara”. Ai, pra, i jep rimës, jo vetëm rëndësi organizuese, por edhe kuptimore.

Poezia e Majakovskit në përkthimin e Moikomit, si dhe në përkthime të tjera në gjuhën tonë, e ka humbur, në mos fare, por e ka humbur fuqinë dhe dinamikën e rimës së tij shpërthyeshe dhe, bashkë me të, ka humbur diçka të veçantë nga timbri i zërit dhe nga temperamentit i tij i furishëm, poezia ka humbur diçka nga ritmi i saj tingëllues marcial. Kjo dëshmon se përkthimi i vërtetë është një mjeshtëri e vështirë. Se të gjithë poetët e mëdhenj janë humbës në përkthim. Kush më pak e kush më shumë.

Ideale, për mendimin tim, do të ishte ajo që profetizon Pushkini në poezinë “Profeti”, po e perifrazoj metaforikisht: përkthyesi duhet ta

“shkulë” gjuhën e vet dhe të “verë” gjuhën e poetit që përkthen. Të heshtë përkthyesi dhe të flasë poeti. Detyrë jo e lehtë, për të mos thënë, aq e vështirë për t'u arritur, gati e pamundur. Prandaj mbetet lapidare shprehja “tradutore, traditore”. Të paktën, kjo “tradhti” të jetë sa më pak penalizuese për përkthyesin.

Poeti ynë i madh dhe i jashtëzakonshëm avangardist, Moikom Zeqo, ka bërë maksimumin e mundshëm në këtë sprovë të më shumë se pesëdhjetë viteve më parë.

Qëllimi kryesor i saj, sipas hamendësimit, tim ka qenë hulumtimi dhe zbulimi i sekretit mjeshtëror të figuracionit novator futurist të Majakovskit.

Moikomi, falë intuitës së tij artistike dhe estetike, të mjeshtërisë dhe të kulturës së tij të gjithanshme, e ka përcjellë në gjuhën shqipe të plotë brendinë emocionale të kësaj lirike të angazhuar qytetare me të gjithë gamën tematike dhe problematikën e jetës së shoqërisë ruse të gati dy dekadave të fillimit të shekullit të njëzetë.

Ai përcjell emocionalisht shpirtin e revoltuar të heroit të tij lirik, që turfullon kundër realitetit borgjez, duke i bërë një kritikë të gjithanshme këtij realiteti.

Moikomi na ka përcjellë bukur intonacionin

e revoltuar satirik të këtij heroi si dhe tragjedinë e vdekjes së njeriut me ideale humane dhe demokratike.

Moikom Zeqo e ka thithur dhe e ka përcjellë në këtë përkthim esencën avangardiste të mjeshtërisë së poetit rus.

Ai ruan natyrën hiperbolike të figuracionit, ruan natyrën spontane të krahasimeve dhe spontanitetin e çuditshëm futurist.

Na e ka sjell filozofinë krijuese të Vladimir Majakovskit, njërit prej firmëtarëve më në zë të manifestit të futurizmit rus të dhjetëvjeçarit të parë të shekullit të njëzetë, poezinë e tij që pati një ndikim reformues, jo vetëm në poezinë ruse.



LETËR PËR PËRKTHIMIN E MAJAKOVSKIT

I dashur Moikom,

Tema e përkthimit është një temë interesante. Për këtë ka shkolla dhe opinione të ndryshme. Procesi i përkthimit, për mua, është, mbi të gjitha, mjeshtëri.

Si çdo mjeshtëri, ka në bazë përvetësimin e një zanati.

Si në çdo zanat, përvoja është kryesorja.

Zbulimi i sekreteve dhe teknikave të caktuara të një diçkaje të krijuar nga një mjeshtër.

Mjeshtërinë e përkthyesit unë do ta përqsja me mjeshtërinë e aktorit, mjeshtërinë e këngëtarit, të instrumentistit, që interpreton një tekst, një karakter, një melodi, një partiturë.

Pra, rikrijimin e një diçkaje të krijuar jo prej tij.

Dhe kjo, patjetër, kërkon një prirje, një talent, që në thelb ka imitim. Poezia është gjinia letrare më e vështirë për t'u përkthyer, për t'u rikrijuar në

një gjuhë tjetër.

Vështirësia e parë lidhet me specifikën gramatikore, me morfologjinë, sintaksën, semantikën, anën tingullore të gjuhës, sa e afërt apo sa e largët është gjuha e përkthimit me gjuhën e origjinalit.

Vështirësia tjetër lidhet me stilin e autorit, me filozofinë e tij krijuese, me temperamentin, me preferencat e tij stilistike dhe estetike, me teknikën e tij krijuese (vargu, metri, ritmi, rimat).

Asnjë përkthim, sado i përsosur qoftë, nuk ia kalon dot origjinalit, është vetëm një kopjo e tij relative.

Prandaj lind mundësia dhe domosdoshmëria e shumë përkthimeve të një autori.

Ashtu siç ka shumë interpretime apo venie skenike të një drame, të një kënge, një opere apo të një simfonie.

Në përkthimin e një poezie mund të preket vargu, metri, rima, por kurrë ritmi dhe figuracioni.

Rima është e diskutueshme.

Kjo është në vartësi të funksionit që i ka caktuar poeti.

Rimat që janë në funksion të melodisë dhe të harmonisë stilistike, të muzikalitetit, që lidhen me ëmbëlsinë lirike të stilit, apo rimat gjëmimtare që shoqërojnë kreshpërimin e ndjenjave apo hapin

marcial të mendimeve. Kur është e pamundur që të arrihen, janë një therori e dhimbshme, por e pashmangshme për të promovuar një poet në një gjuhë tjetër; çdo ngjizje artificiale, mekanike e rimës, e shvlerësojnë, e asgjësojnë origjinalin.

Rima është thembra e Akilit e çdo përkthimi.

Ky mendoj, i dashur Moikom, është fati i Lasgushit tonë dhe i Majakovskit.

Ti ke arritur thelbësoren e thelbësores: figuracionin futurist dhe ritmin muskuloz të poezisë së Majakovskit në librin tend *POEZITE FUTURISTE TE MAJAKOVSKIT*, botim i ZENIT, 2018.

Rimat e Majakovskit janë vërtet të jashtëzakonshme, në harmoni me figuracionin e tij hiperbolik dhe me ritmin dinamik të poezisë së tij.

Rimat novatore të poezisë futuriste të Majakovskit janë në përputhje me figuracionin e tij ekstravagant.

Ato përputhen me dinamikën e emocioneve të tij të jashtëzakonshme duke i përmyllur ato me asociacione adekuate, si tamburi në këngët marciale.

Rimat e tij nuk janë përputhje e zakonshme e zanoreve dhe bashkëtingëlloreve, por asonanca diftongjesh të dy fjalëve. Majakovski ndjek modelin e “çastushkave”, këngëve popullore ruse.

Po të sjell ndonjë shembull (rusisht sigurisht):
“noski’ poda’reni” / “naski’peda’reni”; no’ç njikem/
pozvono’çnji’ke; shago’v mnu/ Go’fmanu; u’lici
u’zki/ kro’vi sgu’stki... Këto rima mbajnë tempin
“oratorik” të poezisë së Majakovskit, poezi e një
tribuni.

*Të fala, Vangjush ZIKO
25 qershor 2018, Kanada*

LASGUSHI I (PA)NJOHUR

Kohët e fundit u botua libri i Moikom Zeqos “Lasgushi i Panjohur”, (Shtëpia botuese Erik, 2017).

Kjo vepër, kushtuar 30-vjetorit të vdekjes së Lasgushit, dëshmon një angazhim dhe guxim të madh për të shkruar dhe medituuar mbi një nga figurat madhore të letërsisë sonë, një nga talentet më madhore të poezisë, një personalitet të rrallë të kulturës sonë kombëtare.

Të gjithëve na duket sikur e njohim Lasgush Poradecin, e vlerësojmë dhe e çmojmë pa mëdyshjen më të vogël. Emri dhe poezia e tij është e njohur nga dy-tre breza shqiptarësh, që kanë lexuar qoftë një poezi të tij. Kjo ndodh në letërsinë botërore me të tilla figura, që janë bërë emblema simbolike në një fushë të caktuar dhe kanë hyrë në fondin e gojëdhënave.

Përmendim emrin e Lasgushit dhe na lind sinonimi i dyfishtë: Poeti dhe Poezia. Mendja na shkon te Pogradeci dhe liqeni i tij, parasysh na del silueta e poetit me republikën dhe kostumin e zi,

që vazhdon të ecë buzë liqenit duke biseduar me valët dhe Cucin e tij besnik, na fanitet fytyra e tij nevrrike me sytë zhbirues që të peshojnë mendimet dhe ndjenjat pa biseduar me ty, por sa e njohim jetën e tij, botën e tij shpirtërore, mendimet dhe shijet e tij për jetën, miqësinë dhe artin.

Moikom Zeqo vendosi ta plotësojë maksimalisht “pazllin” e jetës, karakterit, talentit, filozofisë krijuese dhe raporteve të tij kulturore dhe miqësore me kolegët bashkëkohës, me letërsinë kombëtare dhe atë europiane, veçanërisht.

Poeti, para se të bjerë në pushtetin e magjisë krijuese, është një qenie njerëzore me karakterin, personalitetin, me hobet e pasionet e veta, të cilat e veçojnë nga të tjerët dhe, në të njëjtën kohë, e dallojnë dhe e ngrenë mbi të zakonshmit.

Me të drejtë Moikomi nënvizon atë paradoks të pranuar botërisht se karakteri njerëzor i krijuesit nuk përputhet ose nuk shkon paralel me “karakterin” e krijimtarisë së tij, nuk përputhen huqet apo veset njerëzore me natyrën e divinitetin e krijimtarisë.

Më kujtohet një deklaratë e një mbese të Picassos kur e pyesnin se pse po e shiste një pikturë të trashëguar prej tij. E çuditshme ishte përgjigjja e saj: “nuk e duroj dot, se ka qenë i tmerrshëm me

sjelljen e tij me të afërmit”.

Dihet dhe përcaktimi që i kanë bërë frymëzimit krijues filozofët e kohëve të ndryshme me epitetet “hyjnor” dhe “sëmundje shpirtërore”. Është ky haraçi që paguajnë gjenitë, “kurbani” që i bëjnë krijimtarisë së tyre në shërbim të ushqimit shpirtëror të njerëzve. Moikomi na sjell kujtimin e dhimbshëm të të bijave të Lasgushit nga ai çasti tronditës kur Poeti i gjunjëzuar i puthte ballin e akulluar nga vdekja gruas së tij të dashur duke i kërkuar ta falte për shqetësimet e padëshiruara që i pati sjellë në jetë.

Autori nuk harron pa na zbuluar dhe marrëdhëniet e Lasgushit me dy “vëllezërit dioskurë” të tij: Eqrem Çabejin dhe Mitrush Kutelin. Shembullore është, veçanërisht, miqësia e ngushtë, e sinqertë, njerëzore dhe mjeshtërore midis Lasgushit dhe Çabejit, e dy figurave nga më të shquarat, mjeshtrit të poezisë dhe atij të albanologjisë.

Siç na pohon dhe dëshmon Moikom Zeqo, ekziston një epistolar i pasur i tyre, që përfshin një periudhë 25-vjeçare në të cilin gjejnë pas-qyrim preokupimi reciprok mbi probleme të jetës, të shëndetit personal, përditshmëria e secilit, vizionet e tyre kulturore, intimitetet shoqërore, pra, një komunikim shpirtëror dhe kulturor reciprok.

Miqësia e tyre pohon të vërtetën e madhe, aq të munguar në ditët tona, kur dy talente mbështetin dhe mëkojnë krijimtarinë e njëri-tjetrit me një gjenerozitet të rrallë.

Megjithëse historia e artit është historia e njohur se si brezi i ri e zbret nga anija brezin më të vjetër. Megjithatë, letërsia botërore nuk është gjë tjetër veçse një libër i shkruar dhe i rishkruar brez pas brezi, i pasuruar me shtesa dhe shartime të reja, me ngjyra dhe nuanca të çdo epoke dhe të çdo brezi krijuesish, është, siç thotë Borgesi, një intertekst.

Moikomi me njohuritë, përgatitjen teorike dhe erudicionin e tij na parashtron në këtë libër, në mënyrë krahasuese dhe analitike ndikimet apo mosndikimet e mundshme në krijimtarinë e poetit të poezisë evropiane dhe asaj botërore si dhe të poezisë sonë kombëtare. Ai arrin në përfundimin se Lasgushi është një talent sui generis dhe i papërsëritshëm në llojin e poezisë lirike, se prurja e Poetit në letërsinë shqipe “ishte një mburrje me elemente ekzotike të një panteizmi mistik”.

Çabej e quan Lasgushin “modern dhe kulm të letrave të Arbërisë”. Robert Elsie vlerëson se krijimtaria e Lasgushit është “një revolucion në poezinë shqiptare”; kurse Mitrush Kuteli e cilëson: “i vetmi poet shqiptar që mendon dhe

shkruan shqip". Kritiku Rexhep Qosja ka thënë se ai e ndien Lasgushin "si romantik, mendon si klasicist, asht i vetmuem dhe i hermetizuem si simbolist dhe i kujdesshëm si fanatik ndaj formës së vargut si parnasist. Asht eklektik dhe origjinal në çdo pikëpamje".

Lasgushi është një nga rastet e rralla, jo aq të lehta për t'u përcaktuar vetëm me atributin krijues. Siç konstaton edhe Moikom Zeqo, ai ishte një njohës i mirë i letërsisë kombëtare, i letërsisë klasike dhe asaj moderne europiane. Sidomos asaj gjermane, franceze dhe rumune. Ai e kishte lexuar dhe njohur mirë poezinë e poetëve bashkëkohës gjermanë: Rilke, Pol Celan, George Trakl, apo francezin Bodler, dhe vëçanërisht poetin rumun Emineskun, i cili ishte më i afërti për të dhe me krijimtarinë e të cilit mbrojti edhe doktoraturën.

Poeti ynë diti ta lexojë, ta përzgjedhë dhe të mbështetet e ta çojë më tej, t'i japë vulën e vet, traditës e poezisë sonë kombëtare dhe asaj europiane, siç është rasti me Naimin dhe me Emineskun, të krijojë stilin e tij të papërsëritshëm.

Lasgushi, në mënyrë të veçantë, përthithi nektarin e poezisë popullore, elokuencën e gjuhës shqipe, figurshmërinë, muzikalitetin e saj. Ai, siç shkruan Mitrushin, "hapi Tempullin e gjuhës sonë...

dhe kindat e palosura të fjalëve". Te Naimi ai shikon "simbolin e lindjes dhe rilindjen kombëtare dhe mistikën e udhëheqësit të madh, zemrën e profetit, pa të cilën s'është e mundur ndjekja e asnjë ideali". Lasgushi gjeti dhe pëlqeu te poeti i madh rumun Eminesku pika kontakti, të cilat u bënë frymëzim për të. Ai, sipas Moikom Zeqos, "ashtu si Eminesku beson në atë që quhet figura sintezë e dy antonimive... lind duke "vdekur" ose vdes duke "rilindur" si një Poet i Madh i Shqipërisë".

Vizioni i Lasgushit është një ëndërr vërtet avangardiste për kohën dhe aq më tepër për nivelin në të cilin ndodhej poezia jonë kur ai filloi të botojë veprat e veta.

Në një letër drejtuar Eqrem Çabejt ai i shkruan se është "kundër frymës lokale me kufire të ngushta epike" dhe se për poezinë duhen hapur "horizonte të paanshme"; bën fjalë për "shkëndija kozmogonike" dhe për lartësimin e "makrokozmosit" kombëtar. Ëndrra madhore e Lasgushit ishte që të krijonte "një stil të ri, i cili të përmbante epikë dhe stil dramatik". Ai ishte i bindur se ky stil nuk gjendet i gatshëm, ai "vetëm zbulohet".

Dhe këtë stil Poeti ynë novator e krijoi duke e

ngritur në një pedestal të lartë jo vetëm poezinë e tij, por edhe vetë poezinë tonë kombëtare, e rreshtoi atë përkrah poezisë europiane.

Dhe ja çfarë thotë Moikomi si një sintezë dhe ligjërim lakonik:

“Lasgush Poradeci është dhe mbetet një nga lirikët më të mëdhenj shqiptarë të të gjitha kohërave. Ai është poeti i lartësive dhe thellësive të atdheut të tij poetik, që nuk është gjë tjetër veç se sublimimi i Atdheut të tij gjeografik, historik, që është Shqipëria. Poetika lasgushiane përbëhet nga letërkredencialet e kombit të tij. Të gjitha përsiatjet tona, as nuk e ndriçojnë më tepër, as nuk e errësojnë krijimtarinë e Lasgushit. Lasgushi metaforikisht është i Plagosuri i Madh nga Dashuria”.

Shumë probleme dhe mendime të zgjon ky libër kryesor i Moikom Zeqos me një tematikë universalisht, kaq të pasur. Ai ka renditur mjeshtërisht, por shpesh edhe i kursyer në këtë botim, fakte e dokumente të ndryshme, ditarin dhe epistolarin e Poetit, ç'kanë shkruar të tjerët për të dhe ç'ka shkruar ai për poetët shqiptarë, mbi enigmat e laboratorit krijues të Lasgushit, mbi hobin dhe mendimet e tij për pikturën, përkthimet e tij nga poezia botërore, kujtime për poetin e plot të tjera.

Unë do të vlerësoja, gjithashtu, mësimet që nxjerrim dhe problemet paralele që shtron ky botim lidhur me personalitetin krijues, probleme aktuale të reformimit të vërtetë artistik dhe estetik të krijimtarisë letrare kombëtare për të arritur nivelet e lakmueshme të artit të vërtetë nën shembullin e përvojës së çmuar të këtij artisti vizionar, të mençur dhe erudit.

Shembulli i Lasgushit na jep, në këtë drejtim, një përvojë të mençur, aq të çmuar për krijimtarinë krijuese në këtë periudhë të hapjes dhe të komunikimit intensiv me poezinë botërore, me konceptualitetin modern të artit poetik për të përfituar secili sipas kërkesave dhe synimeve të veta krijuese, pa u bërë epigon apo plagjiator.

Shembulli i personalitetit krijues të Lasgushit na dëshmon se geni i tij guxoi dhe çau një rrugë të re, pa marrë parasysh nivelin e shijes së lexuesit të kohës së vet që, siç shkruan Çabej, kishte shije të cekta dhe “nuk mund ta shijonin thellësinë moderne të tij”.

Lasgushi i ndërgjegjshëm për talentin e vet të jashtëzakonshëm, për gjenialitetin e vet, i bindur dhe i qartë në synimet krijuese, nuk i uli kërkesat e veta artistike, por i parapriu lexuesit duke ecur me besim, këmbëngulje dhe përkushtim drejt artit

të madh e të pavdekshëm.

Është një fat i madh që Moikomi e ka njohur kaq nga afër Poetin, që e ka lexuar dhe studiuar krijimtarinë e tij me përkushtim.

Moikom Zeqo me horizontin e tij kulturor dhe shijet e veta artistike dhe estetike të rralla, me përvojën e vet krijuese avangardiste, me stilin e tij të zhdërvjellët dhe pasionant ka shkruar një vepër të denjë, e cila na e paraqit dhe na e ndriçon nga të gjitha anët e mundshme, e analizon dhe e komenton me dinjitet Lasgushin njeri dhe poet, mendimtar dhe artist.

Moikomi ka shkruar një vepër shumëdimensionale, vepër e cila i kishte munguar lexuesit dhe historiografisë sonë letrare, në përgjithësi dhe asaj të Lasgushit, në veçanti.

**INTERMEXO:
BISEDË E VANGJUS ZIKOS
ME MOIKOM ZEÇON
PËR POEZINË**



1. I dashur Moikom! Poezia lirike nënkupton specifikën e mendimit poetik dhe mënyrën e shprehjes, mishërimit të ndërgjegjes së poetit.

Poeti është njëkohësisht objekt dhe subjekt i pasqyrit në formë bisede të drejtpërdrejtë, me monolog, ose me ndonjë mënyrë tjetër të shënjitimit të ndërgjegjes së vet, ose fshehjes së saj.

Cilën rrugë parapëlqeni?

- I dashur Vangjush, të shprehurit për poezinë lirike është si gjeometria e Lobacevskit, me shumë dimensione, nuk jam i sigurtë se mund të përgjigjem në një mënyrë shteruese mbushamendëse, përfundimtare për poezinë lirike.

Ka gjithmonë një "Mysterum Tremendum",- përcaktimet e zhanrit të poezisë lirike janë gjithashtu të kufizuara,- pavaresisht iluzionit të eksogenezës dhe shtjellimit teorik.

Mund të thuhet gjëra të përgjithshme nga doracakët e stilistikës, ç'difinohet në traktatin e Aristotelit, ose të Pseudo-Longinit, se poezia lirike është e dallueshme dhe e perceptueshme për shkak të moskufizimeve të saja emocionale, se lirika në vetvete është "poezi e

poezisë, një distilim dhe sublimim i fjalës , pa tjetërsime paradoksale".

Lirika gjithsesi parakupton një mënyrë metrike të artikulimit të fjalëve, dhe përgjithësisht por jo në mënyrë absolute kemi të bëjmë me vargjet kanonike të metrikës.

Grekët antikë i quanin lirikat si "ta mele" domethënë "vjersha që duhen kënduar.

Edhe Yetsi përdor fjalën angleze "cantillation", pra "këngëtim".

Ne e njohim përtej formulave linguistike sensin orakullor të lirikës.

Edhe tendencat e shkrirjes së fjalëve në pikturë që i përgjigjen shkrirjes madrigale të fjalëve në muzikë kanë lartësuar shëmbëlltyrat e lirikës si module të brishtësisë dhe të ndërfitjes së pashmangshme mes fjalëve.

Mendimtari i madh i kritikës, Northon Frye thotë "Lirika mund të ketë cdo subjekt dhe cdo formë.

Lirika nuk është e konvencionalizuar nga publiku i saj siç është drama(teatri), sepse lirika është krejtësisht e lirë përtej postulateve mendore, një "sacrificum intellectus" “

Nga ana tjetër unë jam i bindur se lirika që përbën substancën e poezisë në përgjithësi një "outscape" , pra një "brëndësim". Lirika i jep caste pa kufizim në krijimet e saj, pra plot elementë të "carpe diem".

Në tërësi pa kufizime tërë poezia e madhë është një

poezi lirike. Ndarjet e zhanreve në "epikë" dhe "lirikë" janë krejt konvencionale.

Nga Eposi i Veriut mund të veçojë si "mrekulli të mrekullive" liriken madhështore "Ajkuna vajton Omerin".

Kjo poezi e jashtëzakonshme konkurron çdo kryevepër poetike në Europë dhe në botë.

Pra brenda strukturës epike është krejt e lirshme dhe e vetëdijshme shpërthimi i lirikës.

Lirika është klithma e epërme e një jorealiteti të cuditshëm.

Por poeti popullor, i paemërt, që ka krijuar "Ajkuna vajton Omerin", i ka të gjitha atributet e një krijuesi gjenial.

Që kur kam filluar të shkruaj vargjet e para kam menduar në mënyrë naive por dhe genuine se të gjitha poezitë pa përjashtim janë dhe duhet të jenë lirike.

Pra përgjigjen time, i dashur Vangjush, e ke të shumëkuptimëshme.

Nuk jam i mendimit se vetëm vargjet metrike janë lirika.

Kam lexuar lirika të mrekullueshme të Whitmanit të cilat nuk kanë fare rima.

Dogmat, se lirikat janë gjithmonë të rimuara, janë të pakuptimta.

Mund të kujtoj se tek Vedat indiane thuhet "kali

i mendjes duhet te vere samarin e fjalës, të metrave, përndryshe do të humbasë. Zotat që mbajnë jetën në ekuilibër janë metrat,- falë metrave gjithë qeniet e gjalla mbahen poshtë qiellit".

Por e Verteta është përherë anti-dogmatike.

Një teoricien si Lotmani është shprehur" se modaliteti i tekstit shpesh është kundër modalitetit gramatikor."

Arketipet e narracionit letrar i studiuuan formalistët Rusë si Jakobsoni dhe Bahti.

Ata i dhanë rëndësi kuptimshmërisë së Intertekstit.

Lirika në kuptimin më të epërm më iluminues është gjithmonë Intertekst.

2. Teoricienët letrarë thonë se poezia lirike e pohon të renë nëpërmjet ndryshimit të vlefshmërisë së saj të përgjithshme.

Lind pyetja se cilat janë kushtet jashtëletrare dhe mjetet, "instrumentat" kryesorë të procesit krijues, të cilët e determinojnë këtë ndryshim ?

Nuk ka kushte "jashtëletrare", -është shumë e papërcaktuar gjendja shpirtërore në procesin krijues.

Njeriu është një ekzistencë e ndërlikuar,- ku kryesore është shpirti i tij dhe jo përbërësit kimikë ose mekanikë të trupit. Poeti francez Mallarme ka thënë

"në një Muze të Londrës është ekspozuar "Vlera e një njeriu", - një kuti arkivol , e gjatë me ndarje të shumta ku ka amidon, fosfor, miell , shishe uji, alkoli, nikotinë dhe copa të mëdha xhelatine të prodhuar. Unë jam një burrë i tillë".

Për Mallarmen ndryshon statusi i Poetit,- se nuk është një inventar elementësh,- por është Shpirti Avatar i Poezisë.

Edhe Baudelaire tek "Spleen de Paris" shprehet se "fjalët kanë fuqinë të zgjasin të pakufijshmen".

Unë sinqerisht nuk mund ta përcaktoj karakterin konvencional të poezisë lirike.

Megjithatë mund të jap disa shtjellime, që janë në të vertetë hulumtime të miat të amëshimta.

Harold Bloom ka thënë: "Zëri i tjetrit, i demonit flet gjithmonë tek dikush; zëri që nuk mund të vdesë, sepse tashmë i ka mbijetuar vdekjes – poeti i vdekur rron tek dikush. – në fazën e mbrame, poetët e fuqishëm mëtojnë t’u ngjiten të pavdekshmëve, duke jetuar tek poetët e vdekur, të cilët gjëllojnë në ta. Ky Rikthim i vonë i të Vdekurit na grish të njohim motivin zanafillor të katastrofës së mishërimit poetik."

Aventura e Poezisë më ka drobitur, poeti është arketipi i Jobit biblik parahamletian, ose siç shkruan Soren Kierkegard: "çfarë është poeti? – një Fatkeq, që përjeton tortura të rënda shpirtërore, klithmat

dhe rënkimet shndrohen në buzët e tij në muzikë madhështore dhe demoniake.

Shortin e tij mund ta krahasosh me shortin e atyre njerëzve, të cilët i digjnin për së gjalli në një zjarr të ngadaltë brenda demit të bakërt të Falarisit: flitë nuk arrinin ta trondisnin veshin e tiranit me klithmat e tyre, që për të tingëllonin si kumbi i një muzike të ëmbël”.

Dyzimet, zilepsjet, mospranimet, skepticizmi grotesk, urrejtja ndaj poetit janë të vetëkuptueshme, ekzistenciale.

Kësaj thagme nuk i shpëton askush, absolutisht.

As unë.

Vetvetja e poetit dhe vepra e tij nuk janë e njëjta gjë, identiteti është në bigëzim fluid me një vetëdije dhe ritëm orakullor.

Krahasimi delikat dhe i vështirë i Ezra Paundit i lirikës imazhiniste me ideogramin kinez më ka torturuar intimisht, duke e pohuar jo pa ironi dyshuese dhe argëtuese.

Logosi është instrumenti i poetit, jo Fjala.

Është një ndryshim konceptual, ndonëse koncepti i Fjalës është për afërsisht i pazëvendësueshëm, por poezia është shumë më tepër se substanca linguistike, tingëllore dhe grafike.

Poezia e tejkalon teologjinë e teknikave prozadike

si një ikonoklasti e rrezikshme e strukturave pitagorike muzikore dhe numerologjike.

Por edhe mitizmi suksesiv i vargut të lirë, ose i psalmologjisë nuk është absolut e përjashtues i alternativave të panjohura.

Eskatologjia e të shkruarit apokaliptik e universalizon qytetërimin e imazheve.

Sipas Derrida-se destruktivizmi krijues i tekstit, ose i intertekstit është kapërcim i “*gardhimit logocentrik*”.

Këtu fthilëzohet një risi e patjetërsueshme e poezisë së fosilizuar nga kujtesat dhe përvojat mijëravjeçare.

“1) Poezia është makina më e ndërlikuar e intelektit njerëzor. Fuqia sinkronizuese e metaforës (dhe metonimisë) është e pafund *in infinitus*.

2) Maksimalizmi është kur punon edhe me poezinë si formë të mbyllur edhe me poezinë si formë të hapur, asnjë teknikë nuk e përjashton apriori arritjen poetike, ashtu siç nuk ka asnjë që e garanton automatikisht ky është një sekret i madh.

Moskuptimi i këtij sekreti është dështim i sigurt.

2) Po struktura simetrike nuk është gjithçka.

Poezia është udhëtim i gjatë (edhe pas vdekjes) drejt vetëzbulimit.

3) Të pajtosh botën me imagjinatën do të thotë se poezia është një **botë e tretë më sipërane**.

4) Poezia është prova dhe potenciali i intelektit njerëzor ashtu si dhe shkenca, por edhe ndryshe, shkenca dhe poezia nuk përbëjnë një simetri, por më shpesh një asimetri.

5) Ezra Paund – ka thënë: nëse poezia e një kombi pëson rënie, kombi atrofizohet.

Edhe tërë planeti!

6) Poeti e çon gjuhën (leksikun, por dhe gramatikën) jo vetëm në skajet më të largëta të kuptimshmërisë, por shumë shpesh dhe përtej saj.

Kjo është vështirë të kuptohet, akoma më pamjaftueshmërisht të përcaktohet.

7) Përsëri Ezra Paund: “poezia përfaqëson trajtën më të përqendruar të shprehjes verbale”.

8) Kur përdoret një fjalë në poezi, ka thënë Dana Gioja, ajo duhet të jetë shuma (sinteza) e gjithë historisë së saj të përgjithshme, të përshtatshme, potenciale, që është bërë konkrete dhe adekuate në kontekstin individual të autorit.

9). Poezia e shpërthen çdo korse parnasiane, e shkatërron dekorativitetin, qoftë edhe simbolik.

Mineralizimi i shkrimit bën që të humbasë lëvizja e mendimit të gjallë.

Midis stilit lapidaresk dhe stilit shpërthyes ripërtëritja është që në gjenezë vullkanore.

Ambiguiteti i jetës është edhe ambiguiteti i poezisë, misteri është një marramendje kinetike, imazhpllenuese.

10) Çelësi i artë është origjinaliteti, çelësi i vetiaktë.

Këtu është dilema dhe paradoksi kolosal tmerrues.

Kaosi i pamëshirshëm na tjetëron, kulti i parasë është një duel për jetë a vdekje me poezinë.”

Idetë më ngazëllojnë, por edhe më trembin, sepse përgjegjësia e vetëdijes bëhet gati kozmike, përderisa ekzistencialiteti detyrimisht shndërrohet në një poetikë shpëtimtare.

Sipas rikthimit të Homo Poeticus, fjalët na zbulojnë heshtjen e amshuar, si Ekologji të Shpirtit.

Poezitë janë një plotësim, ku kronologjia kalendarike depoziton kristalet e dhimbjes, nostalgjisë dhe revoltës, por ama në pakohësi të paklasifikueshme.

Në çastin e botimit librat e mi s'janë më të mitë,- dhe jam krejtësisht i pambrojtur,- deri në pafundësi.

Lukreci ka shkruar:

*Est etiam magnis Heliconis montibus arbor
Floris odore hominem teatro consueta necare*

Në shqip kjo profeci e përkorë tingëllon kështu:

*Pranë Helikonit, rrotull Kodrës së Diturisë
Rriten pemë, që mbytin Njeriun me lulen e tyre.*

Është e kuptueshme se të shkruash poezi është të familjarizohesh me vdekjen dhe se meditimi poetik është një stilizim i vetëvrasjes.

Më përpara këtë gjë nuk e kam ditur, kurse tani e kuptoj në thelb, por s'kam ç'bëj, nuk tërhiqem dot më.

3.Paradigma thotë se në poezinë lirike, ajo, e cila është shkruar me shekuj, "kryqëzohet" me atë për të cilën nuk është thënë asgjë ende.

Cili është mendimi juaj për këto "kryqëzime" të (pa)ndodhura në poezinë tonë?

- Poezia nuk është një rend elementësh kimikë vec e vec , të paraqitur si në Tabelën e Mendelejevit. Ajo është si uji,- ku oksigjeni dhe hidrogjeni nuk janë vec,por të përbërë në substancën e levizesshme, që ngrin, apo avullohet të ujit.

Nuk mund të thuhet se si zbulohen "kryqëzimet", apo edhe ato që mbiqohen si ndikime.

Shpesh një poezi moderne është si një ëndërr klandestine në mendjen e njerëzimit ose si një Hyjni e Panjohur ende e mbyllur në një kriptë.

Do të sjell këtu në vëmendjen tuaj këto vargje të Pindarit:

Krijesa të ditës:

Ç'është dikush?

Ç'nuk është dikush?

Njeriu është vegim i hijes,

Por kur vjen rrezullimi që jep Zeusi

Drita e epërme shfaqet mbi njerëzit

Dhe jeta është e ëmbël.

P.E.Asterling ka shkruar se "ky fragment i famshëm , në fund të Odës së Mbrame të Pindarit, është kaq i mrekullueshem, sa asnjë deklaratë e vetme nuk mund ta paraqesë kaq bukur këtë vizion të artit."

Më kujtohet dhe një varg i poetit francez Blaise Cendrars:

Les semaphores sous la pluie

në shqip:

Semaforët nën shi.

Poezia ka dicka në vizionet filmike,halucivative , si ato të Gjonit në ishullin e Patmosit.

Le të citoj këtu poetin e madh Migjenin: "asht e idhtë bota jonë(Dheu) në majë të gjuhës së kozmosit."

Imagjinoni se si gjuha e kozmosit ndijon si një test shijen e planetit tonë.

Kjo është një nga metaforat më të plotfuqishme të lirikës së shpirtit apo të asaj që quhet "Imagines Mundi".

Edhe vargu i Isaias: "O, si ke rënë nga qielli Luciferr, o bir i mëngjesit "- nga një premise lirike e pashëmbulltu u bë shkak për krijimin e Eposit Poetik të Miltonit "Parajsa e Humbur".

Cdo gjë në analizat tona mund të jetë e lëvizeshme dhe e barasvlefshme me motive alternative.

Simfonia e Pestë e Bethovenit është në **do minore** dhe jo në **fa maxhore** si Simfonia e Gjashtë e po të njëjtit autor dhe fillon me " sol, sol, sol, mi, bemol".

Asnjëherë nuk kam mundur të kuptoj se si Bach- u është në gjendje të bëj 48 prelude nga një motiv katër notash.

Sot muzika moderne dedakafonike ka autore të tillë si Shenberbu, Ligetti, Zimmerman, Alban Bergu etj.

Kjo i ngjan lirikave, që nuk i shkruan askush me strukturat ritmike të rimave dhe të metrave tradicionale.

Poeti është kaq i plotfuqishëm në imagjinatën e tij sa ka të drejtë ta coje Meduzën tek flokëtari për ta bërë sa më të paraqitshme kokën e saj me flokë gjarpërore.

Është mungesa implicite shpesh e fjalëve që e stimulon argumentin shpirtëror.

Një filozof si Martin Buberi artikulon paradigmën "Unë dhe Ti" ky është sekret i lirikës.

Poetët modernë kanë etje dhe epsh të kërkojnë Arkivat e Edenit për të gjetur Poezitë e Panjohura,- për shkak se janë të neveritur për vdekje nga manderinët ritualë të pseudopoetizimit.

George Steiner ka shkruar se "distanca midis vargëzimit formal dhe Poezisë matet me vite drite".

Walter Beniamini shton:" Një libër mund të presi njëmijë vjet pa u lexuar,- derisa lexuesi i duhur të ndodh, që të vijë."

Ndërkohë nuk jam as kundër poezive metrike dhe me rima.

Levi Straus ka thënë se "shpikja e melodisë është një mister suprem."

Kjo do të thotë se tradita poetike nuk mund të zhduket.

Por do të pasurohet pafundësisht.

Poezia do të krijojë gjuhën universale të metaforave brenda poliglossisë.

Sipas John Ashbery: " krijimi ka disa gramatika të brendshme". Poetët brenda gjuhëve amtare shpikin gjuhën e tyre që përbën "revolucionin e tyre privat , -por për të gjithë".

Jo më kot George Steiner profetizon : "Koperniku i ardhshëm do të jetë njeriu që do të thotë : " Hidhe fjalorin pesemije vjekar të trup-mendjes,- atë dualizëm primitiv, - jam absolutisht i sigurt , që Ajnshtajni i ardhshëm do të jetë njeriu, që do të rimendojë atë çfarë për të gjithë ne tani është fjalor arkaik dhe shpesh i padobishëm."

4. Është e njohur shprehja se brezi i ri poetik i zbret mësuesit nga "anija e Kohës së Re".

Çfarë duhet pranuar dhe çfarë duhet mohuar nga tradita, për të krijuar stilin e vet?

- Nuk është brezi i ri i poetëve , - që bëjnë gjykimin klasifikues, -absolutisht jo.

Asnjë poet pasardhës nuk ka fuqi të skualifikojë poetët paraardhës.

Por ka një Gjendje të Re të Zhvillimit Estetik,- që krijon një Gjyq Mendor të Parimeve Estetike,- që janë jashtë vullnetit të poetëve,- ashtu sic janë dhe ligjet e zbuluara nga Newtoni ,-ose nga formulat e Ajnshtajnit.

Eshte pikërisht Vetëdija Estetike që ngre, vë në relief, ose zbeh, rrëzon dhe kthen në errësirë emrat e krijuesve.

Në të gjitha epokat krijuesit më të popullarizuar kanë patur në publicitetin e tyre edhe shumë motive të opinionit madje dhe të interesave politike.

Kur vdesin shkrimtarët ata duhet të konkurojnë me të vdekurit e medhenj përpara tyre, që janë në Had,- ku nuk ka as tutorë ,as parti politike, as miq nëpër redaksira dhe përballen me vlerat e njëri tjetrit në një" barazi të frikshme të Vdekjes dhe të Amshimit" , ku Kriteri Estetik, është vetëkuptohet me përcaktuesi.

Ky është mendimi im për këtë ceshtje.

5.Cilët janë mësuesit tuaj. Çfarë kini marrë prej tyre. Si dhe sa kini arritur të shprehni vetveten, të krijoni stilin tuaj?

- E kam të vështire të them se cilët janë mësuesit e mi. Unë kam botuar në gazetën" Drita" që në moshën 13 vjec. Naim Frashëri ka ndikuar tek unë me fisnikërinë dhe projektin e tij të madh dhe ekskluziv të gjuhës

letrare shqipe dhe mrekullinë e panteizmit universal. Libri i tij me lirika në persisht " Ëndërrimet" është një libër i jashtëzakonshëm. Poema e Naimit pa subjekt "Bukuria" është nga më të bukurat në rrafsh Europian,- një poemë e tillë mungon fjala vjen tek libri i famshëm i Baudelaire-it.

Padyshim mjeshtri më i madh i lirikës së të gjithë kohërave është De Rada,- me kryeveprën" Milosao," që do ta kishte zili cdo poet i madh i Europës.

Lirizmi i De Radës me ka tronditur në të gjithë qenien time.

De Rada është jo vetëm një romantik i jashtëzakonshëm por Kënga e Parë e "Milosaos" në të vërtetë paralajmëron Poezinë Simboliste shumë më përpara se të shfaqeshin simbolistët në Francë.

Lirik tjetër i madh është Lasgush Poradeci.

Nuk duhet harruar në asnjë mënyrë Serembe,- në poezitë e shkruara në italisht të Serembes unë kam hetuar për afërsi të cuditshme me poezine e poetit italian Leopardi.

Poezi lirike të shkëlqyera ka edhe Ndre Mjeda ,-si dhe Migjeni. Gjatë kohës së Realizmit Socialist poezitë lirike shkruheshin mbi platformen e një epike politike.

Do të përmend këtu dy lirike të mëvetshëm Frederik Rreshpen dhe Dhori Qiriazit,- ata nuk e tradhëtuan "origjinalitetin e vetvetes."

Për sa i përket mjeshtërisë artistike të lirikës në prosodinë shqiptare të pesë shekujve- krijimtari, që nga Gjon Buzuku ,-deri në ditët tona, do të përmendja si një Bibël Estetike të Lirisë- " Rubairat e Omar Khajamit" të Fan Nolit.

Për sa i përket poetëve të huaj tek unë ka ndikuar shumë që në moshën 20 vjecare poetët francezë Arthur Rimbaud, Pierre Reverdy, Majakovski, Bretoni, Lorca, poezia e Georg Traklit,- në mënyrë substanciale më ka clruar nga vargonjtë e dogmave lirika kozmike e Whitmanit.

Nga poetët amerikanë më ka bërë përshtypje të madhe Elioti, Yetsi, Ezra Paund, Stevens si dhe poeti që vdiq 32 vjec Hart Crane për arsye të potencës së tij të Imagjinatës.

Por kam shumë vite që nuk kam përpara syve të mi një Mentor Faustian-, që duhet ta adhuroj.

Jam kundër kultit të poetëve,- por jam për thelbin e poezisë në të gjitha kohërat.

Besoj se kam krijuar sistemin tim figurativ të metaforave të pangjashëm dhe madje të pakrahasueshëm me poetët e tjerë ,-qoftë shqiptarë,- qoftë botërorë.

6. A e përcakton dot autori se cila pjesë e krijimtarisë së tij është një kryevepër dhe cila është pjesë e "konvejerit letrar"?

- Jo autori është i paaftë të përcaktojë me kandarin e argjendarit se cila poezi apo libër i tij është më i cmuar nga pjesa tjetër që mund t'i përkasë edhe Vdekjes së Bardhë, -që ndodh kaq shpesh me krijimtarinë e poetëve.

Një poet nuk është se shkruan shumë libra- dhe nuk përcaktohet nga shumësia e librave.

Poeti krijon dicka që është gati titanike: shpik stilin e tij origjinal ,-të patjetërsueshëm nga të tjerët.


Është e vërtetë që poeti origjinal imitohen kaq shumë, -unë shoh mjaft imitues të poezisë sime,- madje edhe " hajdutë" të metaforave ,apo figurave që strukturohen në librat e mi.

Por epigonizmi është i pashmangshëm.

Nuk kam fuqi për ta ndalur dot.

Madje nuk më intereson fare të merrem me këtë motiv.

**VEPRA TË BOTUARA
TË VANGJUSH ZIKOS**



VEPRA TË BOTUARA TË VANGJUSH ZIKOS

VËLLIME POETIKE

Këngë për Duart

Takim me Malet

Këngët e Grurit

Galeritë e Nëntokës

Magjia e Dashurisë

Ditari Kanadez

Monologu i Ajzbergut

Kulla ime e Babelit

Këtu pranë Polit të Botës

Më zgjo Pëllumb i Noes

Mbase nesër gdhin e diel

DRAMA

Motra Katerinë

Rruga e Madhe

Vëllai i Madh

Prova

Fronti

Martesë pa dasmë

Trëndafili i vetmisë

Taverna "Pandora"

SKENARË DHE LIBRETE

Hapi i Parë (skenar filmi)

Zambakët e Bardhë (skenar filmi)

Brigadierja (libret operete)

PËRKTHIME

A. S. Pushkin – Drama

A. S. Pushkin - Poezi të zgjedhura

S. Esenin - Njëqind Lirika

E. Eftushenko - Lirika

Treqind Vjet Dashuri (Antologji e Poezisë Ruse)

Këmbana e Mbrëmjes (Antologji e Poezisë Ruse)

Tokë e Dashur (Antologji e Poezisë Ruse)

Pegasi Rus (Antologji e Poezisë Ruse)

Aleksis Parnis - Ishulli i Afërditës - Dramë

Vangji-Mihanj Sterju – Pikat e Harruara të Shiut –
Poezi

PROZË

Bezhani

Borëbardha Flokëthinjur (Romancë Kanadeze)

Korça - Qyteti dhe Kujtime

Serenata - Himni i Dashurisë Korçare

Dardha - Legjenda e Feniksit të Pyllit

Thërrmimi i Niagarës (vëllim me tregime)

Drama (Përmbledhje me drama)

Përsiatje (Tradita, Ese, Analiza, Komentë)

Centauri i Poezisë Moderne

